

Jankovska: Maqedonia do ta vazhdojë bashkëpunimin me Kosovën

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska-Jankovska, gjatë vizitës në Kosovë, ka thënë se duhet të fuqizohen raportet me fqinjët në baza të komunikimit të përditshëm për punët që i shqetësojnë të dyja vendet ■ PAGE 2



Na ndiqni edhe në:
www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"



FLET PËR "EPOKËN E RE", EDITA TAHIRI ■ PAGE 4-5

Nuk po shoh vendosmëri për zgjidhjen e çështjeve të mëdha

Ish-zëvendëskryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, ka kritikuar Qeverinë e udhëhequr nga Haradinaj për mosgatishmëri për t'u përballur me tema të mëdha si demarkacioni, asociacioni dhe formimi i ushtrisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se nga kjo Qeveri nuk po shihet serioziteti e as vendosmëri për zgjidhjen e këtyre çështjeve. Tahiri ka bërë thirrje të përshejtohet integrimi evropian i Kosovës në BE dhe NATO si dhe të

lobohet për njohje të reja. Ish-ministria për Dialog ka shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar në çdo kohë delegacionin e ri të Qeverisë për bisedimet në Bruksel. Ajo ka sugjeruar që gjatë dialogut me palën serbe çdoherë t'u referohen dokumenteve shtetërore të Kosovës dhe të mos dalin jashtë platformës shtetërore. Tahiri ka theksuar se vetëm njohja reciproke në mes të dy shteteve sjell paqe dhe stabilitet në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve



AKTUALE

**HASHIM, MOS U
KËRCËNO, SE
ASKUSH MË NUK
TA KA FRIKËN!** F.11



Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA

**TENSIONE NË
HORIZONT, NË
RAST SE KOSOVA
NUK PËRFSHIHET
NË STRATEGJINË
E BE-SË** F.11



Nga Bekim ÇOLLAKU

**KRENARIA E
GJILANIT, MAKFIRE
OSMANI, I THOTË
DISA FJALË PËR
10-VJETORIN E
PAVARËSISË** F.14



Demarkacioni të hënën në kryesi të Kuvendit.

FAÇE 3

Çështja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi të hënën pritet të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Ndërkohë edhe të premtën kanë vazhduar thirrjet për deputetët që sa më shpejt ta

ratifikojnë demarkacionin në mënyrë që Kosova ta përfitojë liberalizimin e vizave. Po të premtën ministria e Integritimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë thirrje për konsensus nacional për këtë çështje

Reçica: Marrëveshja me Zvicrën pritet të nënshkruhet në mars

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka bërë me dije të premtën se marrëveshja për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës pritet të nënshkruhet kah fundi i muajit mars.

Ai ka thënë se qytetarët që përfitojnë nga kjo marrëveshje do t'i gëzojnë pensionet kontributpaguese, pensionet familjare, pensionet invalidore të punës dhe pensionin bazik të moshës ■ PAGE 7



EKONOMI

**MINISTRI LEKAJ: TË GJITHA
FLUTURIMET NGA AEROPORTI
JANË TË SIGURTA** F.8

**'VALA', PESË SUPERPRODUKTE
TË KOMBINUARA** F.9

SPORT

**SHALA: DUA TITULLIN KAMPION
NË HOLANDË** F.18

**NDESHJE INTERESANTE NË
BASKETBOLL** F.18

RENOVA
PUTZ
Macedoni
Xhëgjalt-Telovë
Gazet-Perizaj
E-mail: renova@ml.net.mk
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289

PRINCESHA
GROUP SH.K
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROLKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

SatStyro
Mushnikovë-Prizren-Kosovë
Produkt of EPS and XPS
Mob: +377(0) 44 506 815
Tel/Fax: +381(0) 29 246 030
e-mail: sat_styro@yahoo.com
www.satstyro.com

Kolegji BIZNESI
www.kolegjiibiznesi.com
info@kolegjiibiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERNATIONAL VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Peshko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Jankovska: Maqedonia do ta vazhdojë bashkëpunimin me Kosovën

Ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska-Jankovska, gjatë vizitës së saj në Kosovë ka thënë se duhet të fuqizohen raportet me fqinjët në baza të komunikimit të përditshëm për punët që i shqetësojnë të dyja vendet. Ajo ka theksuar se Maqedonia është e gatshme për kultivimin, zgjerimin dhe avancimin e bashkëpunimit me MFSK-në dhe FSK-në



"Epoka e re"

PRISHTINE, 2 SHKURT - Me ceremoni zyrtare, ministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Rustem Berisha, ka pritur të premten në vizitë, ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska-Jankovska. Ministri Berisha ka falënderuar ministrin Shekerinska për bashkëpunimin e mirë dhe konkret me Ministrinë e Mbrojtjes së Maqedonisë, për gatishmërinë për zgjerimin e fushave të bashkëpunimit si dhe për shkëmbimet e tjera në fushën e trajnimeve, shkollimeve si dhe ushtrimeve fushore. Ai ka konfirmuar aspiratën e Republikës së Kosovës për anëtarësim në NATO dhe integrim në Bashkimin Evropian, duke theksuar se marrëdhëniet e mira me vendet anëtare të NATO-s dhe vendet që aspirojnë për t'u anëtarësuar në NATO janë prioritet i Kosovës. Në këtë kontekst, ministri Berisha ka folur edhe për përgatitjet për transformimin e FSK-së në Forcë të Armatosura të Kosovës (FAK) si forcë e të gjithëve dhe për të gjithë

qytetarët e vendit.

Ndërkaq ministria e Mbrojtjes së Maqedonisë, Radmila Shekerinska-Jankovska, ka theksuar se Maqedonia është e gatshme për kultivimin, zgjerimin dhe avancimin e bashkëpunimit me MFSK-në dhe FSK-në. Ajo ka theksuar se kapacitetet shkollore, trajnuese dhe stërvitore janë të gatshme dhe në dis-

pozicion për aktivitete të përbashkëta.

Të dy ministrat, Berisha dhe Shekerinska-Jankovska, pas takimit, para gazetarëve konfirmuan gatishmërinë për vazhdimin e bashkëpunimit dhe mbështetjen reciproke, bazuar mbi memorandumun e bashkëpunimit ndërmjet dy ministrave, të dy vendeve tona.

Haradinaj: Kosova e Maqedonia të vendosin bashkëpunim për fqinjësi të mirë

Edhe kryeministri i Kosovës, Ramush Haradinaj, ka pritur të premten në takim ministrin e Mbrojtjes të Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska. Thellimi i bashkëpunimit në shumë fusha me rëndësi për të dyja vendet, veçanërisht në fushën e sigurisë, ekonomisë dhe infrastrukturës, menaxhimi i përbashkët i kufijve dhe tema të tjera në interes reciprok, ishin pjesë diskutimi në këtë takim. "Ky është shansi që Kosova dhe Maqedonia ta vendosin bashkëpunimin për fqinjësi të mirë, sidomos tani kur ka vullnet politik nga të dyja vendet", ka thënë Haradinaj. Ndërkaq ministria e Mbrojtjes e Republikës së Maqedonisë, Radmila Shekerinska, ka thënë se duhet të fuqizohen raportet me fqinjët në baza të komunikimit të përditshëm për punët që i preokupojnë të dyja vendet.

LAJME SHKURT

Ambasadori Lu takon Ramën

TIRANË, 2 SHKURT - Ambasadori i ShBA-së në Tiranë, Donald Lu, ka zhvilluar një takim prej rreth 90 minutash me kryeministrin Rama në godinën e qeverisë. Burime nga kryeministria shprehen se në fokus të bisedës është kapja dhe arrestimi i "peshqve të mëdhenj" nga ana e drejtësisë, i paralajmëruar nga ambasadori amerikan.

Ambasadori Lu reagoi këtë të mërkurë, duke kritikuar politikën, policinë dhe prokurorinë, për mosmbajtjen e premtimit për arrestimin e kokave të mëdha të krimit. "Politikanëve, policëve dhe prokurorëve: ju u zotuat përpara popullit shqiptar dhe përpara nesh. Ne investuam në burimet për t'ju ndihmuar në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit. Ku janë rezultatet? Populli shqiptar do që t'i jepet fund pandëshkueshmërisë. Komuniteti ndërkombëtar kërkon rezultate konkrete përpara vendimeve të rëndësishme këtë pranverë. Tik-tak", thuhej në mesazhin e ambasadorit Lu.

Ndërkaq më herët paraditen e së premtes, edhe ministri i Brendshëm, Fatmir Xhafaj, pati një takim me kryeprokuroren Artë Marku, ku në fokus ishte goditja e bandave të rrezikshme të krimit në Shqipëri.

Grupi i Lazaratit dënohet me 52 vjet burgim

TIRANË, 2 SHKURT - Gjykata e Krimeve të Rënda në Shqipëri nxori të premten vendimin për pesë persona të akuzuar se organizonin kultivimin dhe trafikun e marijuanës nga Lazarati. Në total për të pesë të dënuarit u dhanë 52 vjet burgim. Dënimi më i lartë u dha për Arbjon Alikon, 13 vjet heqje lirie. Aliko, së bashku me të vëllanë, është ndërkohë pjesë e një procesi tjetër, atë për vrasjen në vitin 2014 të pjesëtarit të forcave speciale Ibrahim Basha, gjatë një operacioni në Lazarat. Të pesë të dënuarit u arrestuan pas ndërhyrjes që policia realizoi në vitin 2014, në fshatin Jugor, i cili deri në atë kohë konsiderohej si Republika e marijuanës, edhe për shkak se përpjekjet e mëparshme të forcave të rendit për të hyrë në Lazarat kishin dështuar.


Ahmeti: Referendumi për emrin mund ta ndërlikojë procesin

SHKUP, 2 SHKURT - Marrëveshja për emrin duhet të arrihet sa më shpejt dhe të ratifikohet në parlament, deklaroi lideri i BDI-së, Ali Ahmeti, në takimin e së premtes me eurodeputetët Viktor Boshinaru, Tanja Fajon dhe Tonino Picula. "Referendumi i mundshëm mund ta ndërlikojë procesin", theksoi ai. "Kompromisi për zgjidhjen e çështjes së emrit duhet të arrihet tani, duke respektuar karakteristikat e palëve dhe duke menduar për të ardhmen e përbashkët në familjen evropiane", thonë burime nga BDI-ja. "Ahmeti dhe tre eurodeputetët biseduan shumë hapur dhe miqësisht për çështjet e interesit të përbashkët, siç janë integrimi euroatlantik, fqinjësia e mirë dhe reformat", thuhet në njoftimin e BDI-së. Ahmeti e përshëndeti mbështetjen e eurodeputetëve dhe tha se perioda që na paraprin është vendimtare jo vetëm për Maqedoninë, por edhe për rajonin.

Kryesia e Kuvendit të Kosovës javën e ardhshme pritet ta shqyrtojë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi

Demarkacioni të hënën në kryesi të Kuvendit

Çështja e demarkacionit të kufirit me Malin e Zi të hënën pritet të jetë pikë e rendit të ditës në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Ndërkohë edhe të premten kanë vazhduar thirrjet për deputetët që sa më shpejt ta ratifikojnë demarkacionin në mënyrë që Kosova ta përfitojë liberalizimin e vizave. Po të premten ministria e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, ka bërë thirrje për konsensus nacional për këtë çështje



EPOKA E RE Shqipe **HETEMI**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Marrëveshja e demarkacionit me Malin e Zi pritet të shqyrtohet të hënën në mbledhjen e kryesisë së Kuvendit të Kosovës. Gazeta "Epoka e re" ka marrë vesh, nga burimet brenda Kuvendit, se kjo mbledhje do të mbahet në orën 11:00. Ndërsa ministria e Integrimit Evropian, Dhurata Hoxha, të premten ka kërkuar konsensus nacional për procesin e integritimit. Ajo u ka bërë thirrje deputetëve që sa më shpejt ta ratifikojnë demarkacionin me Malin e Zi. "Kërkoj nga deputetët të nxirret një rezolutë e përbashkët nga Kuvendi me konsensus të të gjitha partive politike për ta shprehur zotimin për t'i avancuar proceset e integritimit, sepse integritimi evropian nuk ka alternativë. Duhet të flasim me një zë dhe të kemi një qëndrim të përbashkët, dhe prioritet i politikave dhe ligjeve për MSA-në dhe ERA si konsensus ndërinstucional. Duhet të bëhen reforma në drejtësi, ekonomi dhe administratë", ka deklaruar Hoxha gjatë takimit me anëtarët e Komisionit Parlamentar për Integritime Evropiane, ku është diskutuar për strategjinë e zgjerimit të Bashkimit Evropian për shtetet e Ballkanit Perëndimor.

Ajo ka thënë se pret që kjo strategji ta njohë progresin e arritur dhe ta konfirmojë avancimin e procesit integruar të Kosovës në Bashkimin Evropian. "Jemi plotësisht të vetëdijshëm për kufizimet objektive, respektivisht mosnjohjen nga pesë vendet anëtare të BE-së, njëkohësisht jemi të bindur se nëse sigurojmë përmbushjen e detyrave të shtetësisë përmes zbatimit rigoroz të MSA-së, Bashkimi Evropian do të gjejë mënyra për ta avancuar më tutje procesin integruar të Kosovës", është shprehur Hoxha, duke shtuar se procesi integruar i Kosovës ka pasur një avancim progresiv në vitet e fundit. "Kemi siguruar Marrëveshjen e Stabilizim Asociimit, jemi në prag të liberalizimit të vizave, kemi siguruar qasje në programet e BE-së dhe jemi përfitues më të mëdhenj për kokë banori të asistencës së BE-së. Nuk duhet harruar që prioritet i parë i institucioneve tona duhet të jetë zbatimi i reformave të gjithëmbarshme të parapara me MSA-në. Vetëm rezultatet e bindshme dhe progresi në kuadër të normalizimit të marrëdhënieve me Serbinë do t'i vendosë institucionet tona me një pozitë ku mund të kërkojmë më shumë nga ana e BE-së. Për momentin, topi është në anën tonë t'i përfundojmë detyrat e shtetësisë", ka deklaruar ministria

Hoxha. Një ditë më parë edhe presidenti Hashim Thaçi u ka bërë thirrje deputetëve që në një të ardhme të afërt ta miratojnë marrëveshjen e demarkacionit me Malin e Zi në mënyrë që qytetarët të lëvizin pa viza. Ai ka thënë se Kosova do të jetë e përfshirë qartësisht në strategjinë e zgjerimit të BE-së për vendet e Ballkanit Perëndimor. Por, sipas presidentit, kësaj qartësie evropiane do t'i ndihmojë shumë edhe vendimarrja e institucioneve në ditët dhe javët e ardhshme. Duhet dhe do t'i kryejmë detyrat dhe obligimet që kemi marrë përsipër

karshi bashkësisë ndërkombëtare në mënyrë që të lehtësohet procesi i liberalizimit të vizave dhe e

ardhmja konkrete evropiane e Kosovës. Dua të besoj se në të ardhmen e afërt do të përmbyllet edhe çështja e demarkacionit në mënyrë që qytetarët e vendit të lëvizin lirshëm", ka theksuar Thaçi.

Kosova e ka shansin e fundit të dalë nga izolimi

Drejtori i Qendrës Kosovare për Studime të Sigurisë (QKSS), Florian Qehaja, ka vlerësuar se Kosova ka shansin e fundit për të dalë nga izolimi dhe apatia e përgjithshme. Ai ka thënë se Kuvendi duhet të mbledhet dhe ta votojë demarkacionin që hap dyert për liberalizim të vizave. Qehaja ka deklaruar se liderët e kanë rastin e fundit për të vepruar me pragmatizëm dhe për interesa të vendit. "Kosova e ka shansin e fundit, absolutisht të fundit, që ta nxjerrë vendin nga izolimi dhe apatia e përgjithshme. Kuvendi duhet të mbledhet dhe ta votojë

demarkacionin që hap dyert për liberalizim të vizave. Me këtë vendim topi do të hidhet krejtësisht në BE dhe vonesat e mundshme nga kjo e fundit do të konsideroheshin kryekëput shkelje e të drejtave të njeriut dhe segregacion kolektiv. Versioni aktual i demarkacionit do të mund të rikonsiderohej në një moment të përshatshëm bazuar në provat që po pretendohet se do t'i kishim. Liderët e kanë rastin e fundit për të vepruar me pragmatizëm dhe vetëm për interesa të vendit", ka shkruar Qehaja në llogarinë e vet në "Facebook".

Veseli: Kosova nuk ka kohë të humbë në rrugëtimin euroatlantik



PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i Kuvendit të Kosovës, Kadri Veseli, ka takuar të premten përfaqësuesit e Këshillit Gjyqësor të Kosovës, të Këshillit Prokurorior dhe ministrin e Drejtësisë në Kosovë, ndërsa në takim ishin të pranishëm edhe përfaqësues nga Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë dhe përfaqësues të Ambasadës së SHBA-së. Në takim u fol për proceset nëpër të cilat po kalon vendi ynë, si në aspektin e brendshëm, veçanërisht në sektorin e drejtësisë, ashtu edhe

në procesin e integritimit euroatlantik. Veseli ka thënë se prioritet nacional i Kosovës është integritimi euroatlantik, ndërsa ka shtuar se vendi po bën përpjekje për ta arritur sa më parë liberalizimin e vizave. "Përveç demarkacionit, që është një kusht kryesor për ta siguruar lëvizjen e lirë dhe për të cilin pres një konsensus të gjerë, edhe sundimi i ligjit është një çështje e rëndësishme që tashmë është plotësisht si kriter, por që duhet të vazhdojë, sepse e forcon shtetin e Kosovës", ka thënë Veseli.

Flet për "Epokën e re", Edita Tahiri

Nuk po shoh vendosmëri për zgjidhjen

Ish-zëvendëskryeministria e Kosovës, Edita Tahiri, ka kritikuar Qeverinë e udhëhequr nga Haradinaj për mosgatishmëri për t'u përballur me tema të mëdha, si demarkacioni, asociacioni dhe formimi i ushtrisë. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ajo ka thënë se nga kjo Qeveri nuk po shihet serioziteti e as vendosmëri për zgjidhjen e këryre çështjeve. Tahiri ka bërë thirrje të përshpejtohet integrimi evropian i Kosovës, në BE dhe NATO, si dhe të lobohet për njohje të reja. Ish-ministria për Dialog ka shprehur gatishmërinë për ta ndihmuar në çdo kohë delegacionin e ri të Qeverisë për bisedimet e Brukselit. Ajo u ka sugjeruar atyre që gjatë dialogut me palën serbe t'u referohen çdoherë dokumenteve shtetërore të Kosovës dhe të mos dalin jashtë platformës shtetërore. Tahiri ka theksuar se vetëm njohja reciproke në mes të dy shteteve sjell paqe dhe stabilitet në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve



PRISHTINË, 2 SHKURT -

"Epoka e re": Znj. Tahiri, Qeveria e Kosovës ka caktuar një delegacion të ri për bisedimet teknike me Serbinë në Bruksel, në të cilin ju nuk jeni përfshirë.

Tahiri: Ne kemi pasur zgjedhje të parakohshme nga të cilat është formuar Qeveria e re me aktorë të tjerë politikë, të cilët i kanë formulat për këtë proces të dialogut. Në fillim kryeministri ka qenë kundër dialogut dhe nuk i ka vlerësuar arritjet e mëdha që i ka dhënë ky proces por tani, meqenëse është caktuar një delegacion për dialog, tregon se ka ndryshim të qëndrimit të kësaj Qeverie dhe tashmë qartë vlerësojnë se Kosova e ka shtrirë sovranitetin shtetëror në veri të vendit falë këtij dialogu dhe falë punës shtatëvjeçare që kemi pasur si Qeveri në herët.

"Epoka e re": Meqenëse e ke parë tashmë përbërjen e këtij delegacioni, në krye të të cilit është emëruar Avni Arifi, këshilltar i kryeministrit, cili është mendimi juaj për këtë përbërje të delegacionit?

Tahiri: Në gjithë karrierën time politike kam qenë institucionaliste. Kam respektuar gjithmonë institucionet. Ky delegacion është vendim i Qeverisë. Ky delegacion ende nuk e ka filluar punën, meqenëse takimi i parë u anulua për shkak të incidentit të vrasjes në veri. Kurse tani nuk mund të jap ndonjë vlerësim, sepse duhet parë punën e tyre dhe tek pastaj mund t'i jap vlerësimet e mia.

"Epoka e re": Si politikanë që prej fillimit keni qenë pjesë e këtij proces, çfarë duhet të ndryshojnë delegacioni i ri dhe Qeveria e re në këtë proces?

Tahiri: Ky delegacion e ka situatën më të qartë dhe më të lehtë

në një kuptim. Dialogu i Brukselit është zhvilluar mbi platforma të qarta të Qeverisë së Kosovës dhe ju e dini, unë vazhdimisht i kam pasur vijat e kuqe në këtë proces dhe ato i kemi respektuar plotësisht, për faktin se të gjitha marrëveshjet që janë arritur në Bruksel janë në pajtim me ligjet dhe Kushtetutën e Kosovës. Ky proces ka qenë dialog për fqinjësi të mirë mes dy shteteve dhe nuk ka të bëjë me tema të brendshme të Kosovës apo me statusin e Kosovës. Tani Kosova është shtet i pavarur dhe sovran i njohur nga mbi 100 shtete. Dhe ky dialog në këta shtatë vjet ka dhënë rezultate të mëdha. Dialogu ka qenë për ndërprerjen e ndërhyrjeve të Serbisë në territorin e Kosovës. Ne kemi arritur që në të gjitha fushat t'i shpërbëjmë strukturat paralele. Po ashtu, kemi vendosur institucionet shtetërore në veri, sepse para këtij procesi ka pasur polici paralele serbe, gjyqësi paralele, doganë dhe kufi të mbyllur. Të gjitha këto çështje i kemi zgjidhur me marrëveshjet e Brukselit, duke shtrirë sovranitetin tonë shtetëror në atë pjesë. Po ashtu, falë këtij dialogu katër komunat veriore kanë filluar të marrin pjesë në zgjedhje. Tani gjithnjë e më shumë serbët e verit kërkojnë të integrohen në institucionet shtetërore të Kosovës. Dihet se që nga pas lufta kemi pasur probleme në veri të vendit, por ky dialog ka mundësuar ta vendosim juridiksionin shtetëror edhe në pjesën veriore të vendit.

Gjithashtu, falë këtij procesi Kosova ka marrë kodin shtetëror telefonik që nuk e ka pasur më herët. Duke qenë pjesë e këtij procesi, Kosova ka hequr shumë pengesa në anëtarësimet e

organizatave rajonale dhe ndërkombëtare. Gjithashtu, Kosova ka nënshkruar MSA-në dhe ka hyrë në rrugën zyrtare të integritetit evropian falë këtij dialogu. Natyrisht se kjo është arritur edhe falë reformave në të gjitha fushat. E përmenda dialogun, sepse pesë vendet anëtare të BE-së të cilat ende nuk e njohin Kosovën kanë votuar për integrimin evropian të Kosovës. Pra, Kosova si shtet përmes këtij dialogu ka dhënë dëshmi se është një partner serioz për stabilitet dhe paqe në rajon. Të gjitha këto janë arritje të këtij procesi. Ndërsa tani ky delegacion i ri mjafton t'i respektojë platformat shtetërore të Kosovës.

"Epoka e re": Ka kërkuar ndihmë nga ju ky delegacion?

Tahiri: Unë e kam njoftuar me këto platforma këtë delegacion, sepse ka kërkuar ndihmë në këtë drejtim. I kam treguar se të gjitha janë në uebsajtin e Qeverisë dhe kurdo që ka ndonjë pyetje jam e gatshme që me shkrim t'i kthej përgjigje. Po ashtu, në uebsajt të Zyrës së Kryeministrit është edhe platforma për fazën e fundit të dialogut.

"Epoka e re": Çfarë parasheh kjo fazë?

Tahiri: Kosova tashmë ka paraqitur platformën për fazën finale të procesit. Në atë platformë kemi theksuar qëndrimin shtetëror, që vetëm njohja reciproke në mes të dy shteteve sjell paqe dhe stabilitet në marrëdhëniet ndërmjet dy shteteve, si dhe paqe të qëndrueshme në gjithë rajonin. Po ashtu, kemi përmendur edhe çështjet madhore që duhet të diskutohen në këtë fazë si demarkacioni i kufirit mes dy shteteve, reparacionet e luftës dhe kompensimet që Serbia duhet t'i bëjë Kosovës për dëme që ia ka shkaktuar në luftë. Normalizimin e marrëdhënieve mes dy shteteve e shohim vetëm përmes njohjes reciproke ndërmjet dy shteteve. Kjo do të mbyllte kapitullimin e armiqësisë ndërmjet dy vendeve dhe do ta hapte kapitullin e fqinjësisë. Prandaj, delegacioni i ri duhet vetëm t'u referohet dokumenteve shtetërore që janë zyrtare, sepse tani e kanë më të lehtë se i kanë të gatshme.

"Epoka e re": Por, ende kemi disa marrëveshje që janë në proces të zbatimit dhe disa që nuk janë zbat-

uar fare nga ana e Serbisë. A do të duhej që Kosova ta kushtëzojë vazhdimin e këtij procesi me zbatimin e këtyre marrëveshjeve?

Tahiri: Siç e dini, në korrik të vitit të kaluar unë i kam dorëzuar një raport zyrtar Brukselit, ku është theksuar se rreth 10 marrëveshje janë të pazbatuara ose janë në proces të zbatimit. Në këtë raport kam treguar se cili shtet ka ngecur në zbatim të atyre marrëveshjeve. Shumica e këtyre marrëveshjeve nuk janë zbatuar nga Serbia, por disa marrëveshje edhe Kosova duhet t'i zbatojë, sepse e ka obligim. Prandaj, po them se të dyja shtetet duhet t'i kryejnë obligimet që i kanë për zbatimin e këtyre marrëveshjeve. Në këtë mënyrë është mirë që ka rifilluar dialogu dhe duhet të ndodhë zbatimi i marrëveshjeve, e pastaj të vazhdohet me fazën finale të dialogut.

"Epoka e re": Siç dihet, këtë pjesën politike të dialogut me Serbinë do ta udhëheqë presidenti i vendit. Mund të presim që ju të bëheni pjesë e ekipit të presidentit?

Tahiri: Çështja e temave të mëdha për shtetin nuk është e lidhur me politikanë të veçantë. Me rëndësi është që kjo Qeveri të jetë e aftë dhe t'i japë përgjigje

e çështjeve të mëdha



temave të mëdha. Dialogu Kosovë - Serbi është vetëm një prej këtyre temave të mëdha. Janë edhe disa tema më urgjente që populli hapur po pret të zgjidhen, çështja e liberalizimit të vizave, e cila është e lidhur me ratifikimin e demarkacionit me Malin e Zi. Ndonëse kjo qeveri erdhi në pushtet pikërisht me synimin se do ta zgjidhë këtë çështje, ende nuk është e aftë të japë zgjidhje, ndërkohë kjo po e mban të izoluar Kosovën. Temë tjetër e madhe është çështja e ushtrisë. Populli është në pritje të formimit të ushtrisë. Gjithashtu, sfida mbeten zhvillimi ekonomik dhe hapja e vendeve të punës. Pra, këto janë detyrat e kësaj qeverie, ndërsa se kush do të jetë në ekipin e nivelit politik, ka kohë për të biseduar.

"Epoka e re": A besoni se kjo Qeveri është e gatshme dhe mund t'u japë zgjidhje këtyre temave të mëdha: demarkacionit, asociacionit dhe ushtrisë?

Tahir: Si politikane me përvojë, zakonisht nuk nxitohem të jap vlerësime për punën e institucioneve, prandaj edhe nuk kam dhënë deklarime mediale në 100 ditët e para të kësaj qeverie. Mirëpo, tani jemi në muajin e


pestë të kësaj Qeverie, sinjerisht nuk po shoh seriozitet dhe nuk po shoh ide apo koncepte të qarta se si do të zgjidhen këto çështje nga kjo Qeveri. Po shoh angazhim të saj, por për aq sa e kam përcjell nga mediet, nuk po shoh seriozitet dhe as vendosmëri për zgjidhjen e këtyre temave. Kjo nuk do të thotë se ato nuk bëhen, por deri më tani nuk më kanë bindur se kanë fuqi për zgjidhjen e këtyre çështjeve që janë me interes shtetëror. Kosova është një shtet që tani është në prag të 10-vjetorit të pavarësisë. Gjatë kësaj periudhe ka bërë përparime shumë të rëndësishme, por ende kemi nevojë për vendime të mëdha, të cilat i përmenda. Pra, kemi nevojë ta përshpejtojmë integrimin evropian, integrimin në NATO dhe kemi nevojë për njohje të reja. Prandaj, do të kisha dashur të shoh rezultate nga kjo Qeveri. Pesë muaj nuk janë shumë, por për fillim rezultati nuk ka qenë premtues. Kjo nuk do të thotë të mos ndryshojë diçka.

"Epoka e re": Publikimi i Strategjisë së Zgjerimit të Komisionit Evropian për integrimin evropian të vendeve

të Ballkanit Perëndimor pritet të publikohet së shpejti. Shqetësimi është se kjo strategji mund të mos i ofrojë Kosovës një perspektivë shumë të qartë evropiane. Janë reale këto shqetësime?

Tahir: Kosova domosdoshmërisht do të jetë pjesë e strategjisë së zgjerimit të BE-së. Janë disa arsye pse kjo do të ndodhë. Së pari, zgjerimi i BE-së drejt Ballkanit Perëndimor i shërben paqes dhe stabilitetit jo vetëm në Ballkan, por edhe në Evropë. Nëse BE-ja nuk do t'i përfshijë të gjitha shtetet në këtë strategji dhe nëse BE-ja nuk i detyron të gjitha shtetet t'i mbyllin çështjet e hapura bilaterale, atëherë Ballkani do të mbetet pezull dhe do të bëhet një terren për ndërhyrjen dhe ambiciet gjeopolitike të vendeve joperëndimore. Pretendimet e disa prej tyre tashmë i kemi parë hapur, siç është Rusia dhe dukuritë e radikalizmit. Pra, është koha që jo vetëm BE-ja, por edhe partnerët evropianë dhe amerikanë bashkë ta vendosin këtë strategji në mënyrë që t'ua japim mesazhin faktorëve joperëndimorë se Ballkani është rajon euroatlantik dhe tani mbrohet nga partnerët euroatlantikë.

Së dyti, vetë vendet e Ballkanit duhet ta shohin interesin e tyre në integrimin evropian. Ne, Kosova, përveçse kemi shprehur qartë synimin për t'u bërë pjesë e BE-së dhe NATO-s, duhet t'i kryejmë edhe obligimet ndërkombëtare që i kemi marrë. Obligimet tona janë që t'i përmbysim kriteret që janë përcaktuar nga BE-ja dhe NATO-ja. Në këtë fazë, ne kemi disa kriterë që duhet t'i plotësojmë dhe sigurisht se këto obligime duhet t'i plotësojmë në mënyrë që të japim shembull se ne jo vetëm që kemi synime euroatlantike, por edhe e meritojmë këtë.



Pacolli rikonfirmon njohjen nga Guinea Bisau

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Ministri i Punëve të Jashtme, Behgjet Pacolli, ka publikuar faksimilen e notës zyrtare të Guinea Bisau që rikonfirmon njohjen e Kosovës nga ky shtet. Madje Pacolli i ka akuzuar mediet se po ushqehen me informacionin zyrtar serb, duke shtuar se ato nuk shkojnë në zyrat e institucioneve që kanë afër. "Guinea Bisau rikonfirmon se ky shtet e njeh Kosovën, ndërsa ndonjë media jonë vazh-

don ende të ushqehet me informacionin zyrtar serb. Ky nuk është rasti i vetëm që ndodh kështu, mjerisht. Për keqardhje që këta njerëz të medies nuk vijnë në zyrat e institucioneve tona të cilat i kanë afër. Puna e Ministrisë sonë të Jashtme nuk matet me zhurmën e medieve apo të institucioneve serbe, as me jehonën e tyre pasqyruese në disa media të Kosovës", ka shkruar Pacolli në llogarinë e vet në "Facebook".

Ministri i Punëve të Brendshme suspendon kryeshefin e IPK-së

PRISHTINË, 2 SHKURT - Kryeshefi ekzekutiv i Inspektoratit të Policisë së Kosovës, Hilmi Mehmeti, është suspenduar nga pozita që mbante. Suspendimin e Mehmetit e ka bërë ministri i Punëve të Brendshme, Flamur Sejfi. "Kalko.com" ka kontaktuar me kryeshefin e IPK-së, Hilmi Mehmetin, për ta pyetur në lidhje me suspendimin. Ai ka thënë se deri te suspendimi ka ardhur pas një hetimi i cili është duke u zhvilluar. "Është në pyetje një hetim i cili është duke



u zhvilluar. Deri në përfundim të hetimit do të jem i suspenduar me pagesë", ka thënë Mehmeti.

Haradinaj: Jemi të përkushtuar t'i mbrojmë fëmijët tanë



Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHt) ka organizuar të premten konferencën "Edukimi, çelës për t'u përballur me ekstremizmin dhe radikalizmin online"

EPOKA E RE **Qendresa RAMA**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë (MASHt) ka organizuar konferencën njëditore me temë "Edukimi, çelës për t'u përballur me ekstremizmin dhe radikalizmin online", e cila është realizuar me rastin e fillimit të "Javës për internet të sigurt", me moton: "Krijë, lidhu dhe trego respekt: një internet

më i mirë fillon me ty". Duke theksuar rëndësinë e luftimit të radikalizmit dhe ekstremizmit online, kryeministri Ramush Haradinaj ka theksuar se do të jenë të vendosur dhe të bashkuar që të mos lejojnë askënd t'i marrë fëmijët. "Qëllimi i Kosovës është t'i themi stop depërtimit, mbështetjes dhe marrjes së fëmijëve. Dikur është vonë nëse nuk reagojmë me kohë. Nuk guxojmë dhe s'do ta lejojmë këtë.

Kushdo që bën pagë me këtë, është duke u pajtuar që fëmija i tij/saj ta ketë atë fat. Do të jemi bashkë, do të jemi unikë dhe të vendosur që mos ta lejojmë këtë. Do t'i gjejmë të gjitha rrugët, mundësitë dhe mjetet e nevojshme që kjo mos t'i ndodhë Kosovës", ka deklaruar Haradinaj.

Para të pranishmëve, kryeministri Haradinaj u zotua se nuk do të ndalet në mbrojtjen e fëmijëve nga çfarëdo ekspozimi i keq. "Apeli është i qartë, nuk është alternativë ideologjia që çon kah terrorizmi, nuk është zgjidhje, është mashtrim për familjet tona", është shprehur kryeministri, duke falënderuar edhe partnerët ndërkombëtarë

që kanë ndihmuar në këtë rrugë.

Ndërsa ministri i Arsimit, i Shkencës dhe i Teknologjisë, Shyqiri Bytyqi, ka thënë se dukuria e rrezikut nga interneti nuk po ndodh vetëm në Kosovë por, fatkeqësisht, e ka përfshirë një pjesë të madhe të botës. Ministri Bytyqi ka theksuar se janë dëshmitarë që fëmijët në mbarë botën shpenzojnë një kohë të gjatë duke përdorur internetin online, pa qenë të vetëdijshëm që ky përdorim mund t'i shkaktojë dëm shëndetit, por edhe përgatitjes së tyre. "Gjithë ky rrezik të cilit po i ekspozohen fëmijët tanë, po sjellë një pasiguri e cila është jo e lehtë të kontrollohet, sepse

fëmijët dhe të rinjtë tanë nuk janë të vetëdijshëm për rrezikun që po u kanoset në formën e përdorimit online të internetit. Këta të rinj nuk e kanë vetëdijen e plotë për pasojat negative qofshin ato psikologjike apo sociale, duke lënë mundësinë të kalojnë edhe në radikalizëm apo ekstremizëm të dhunshëm online", ka thënë ministri Bytyqi.

Ministri Bytyqi ka pohuar se janë të angazhuar për zbatimin e Strategjisë dhe Planit të Veprimit për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm që shpie në radikalizëm 2015-2020, në mënyrë që ta parandalojnë këtë dukuri negative dhe t'i mbrojnë fëmijët dhe të rinjtë tanë.

Mbahet takimi rajonal për kontrollin e armëve të vogla

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - një takim me delegacionin nga Zyra Federale e Punëve të Brendshme, Izmi Zeka, zëvendësministri i Punëve të Jashtme, Anton Berisha dhe një delegacion me përfaqësues nga Policia e Kosovës dhe të MPJ-së, kanë marrë pjesë në takimin e nivelit të lartë rajonal, të organizuar nga SEESAC dhe Zyra Federale e Jashtme e Gjermanisë. Ky takim po mbahet në Podgoricë, ku po marrin pjesë zëvendësministrat e brendshëm dhe të jashtëm nga vendet e Ballkanit Perëndimor. Gjatë qëndrimit në Podgoricë delegacioni nga Kosova pati

një takim me delegacionin nga Zyra Federale e Jashtme e Gjermanisë, si donatorët kryesorë në projektet e ndryshme me qëllim të kontrollit të armëve të vogla dhe të lehta. Në këtë takim u diskutuan të arriturat e Kosovës dhe sfidat në këtë fushë. Po ashtu, u diskutuan hapat e ardhshëm në drejtim të përmbytjes së standardeve ndërkombëtare dhe projektet konkrete që do të ndikojnë në reduktimin e numrit të armëve të paligjshme që gjenden ende në duar të popullatës. Në këtë takim u kërku



mbështetje për implementimin e ligjit për legalizim dhe ngritjen e kapaciteteve të Policisë së Kosovës dhe

Prokurorisë në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve, si dhe u kërku për krahe për ngritjen e

bashkëpunimit ndërkombëtar policor dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Në fund të takimit është miratuar një deklaratë e përbashkët për t'i ritheksuar angazhimet dhe përpjekjet e të gjitha shteteve të rajonit në luftën kundër trafikimit të paligjshëm të armëve, në të cilën janë vlerësuar të arriturat dhe përpjekjet e vendeve të rajonit në këtë drejtim dhe janë zotuar për angazhime shtesë dhe përmirësimin e bashkëpunimit rajonal dhe ndërkombëtar.

Reçica: Marrëveshja me Zvicrën pritet të nënshkruhet në mars

Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka bërë me dije të premten se marrëveshja për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës pritet të nënshkruhet kah fundi i muajit mars. Ai ka thënë se qytetarët që përfitojnë nga kjo marrëveshje do t'i gëzojnë pensionet kontributpaguese, pensionet familjare, pensionet invalide të punës dhe pensionin bazik të moshës



**EPOKA
ERE** **Faton DERMAKU**

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministri i Punës dhe Mirëqenies Sociale, Skender Reçica, ka marrë pjesë të premten në takimin e Komisionit Parlamentar për Shëndetësi, Punë dhe Mirëqenie Sociale, gjatë të cilit është diskutuar rreth marrëveshjes për sigurime sociale në mes të Republikës së Kosovës dhe Konfederatës së Zvicrës.

Ministri Reçica, duke raportuar

para anëtarëve të komisionit lidhur me marrëveshjen në fjalë, paralajmëroi se ajo pritet të nënshkruhet kah fundi i muajit mars. Reçica ka njoftuar të pranishmit se grupet teknike të të dyja shteteve tashmë kanë finalizuar draftin e marrëveshjes së përgjithshme për sigurime sociale në mes të Kosovës dhe Zvicrës dhe marrëveshjes administrative për zbatimin e marrëveshjes së përgjithshme. Ai ka bërë me dije se të dyja këto draft marrëveshje

MPMS-ja i ka përcjellë për në Ministrinë e Jashtme të Kosovës. Duke folur rreth përmbytjes së marrëveshjes, ministri Reçica ka thënë se qytetarët që përfitojnë nga kjo marrëveshje do të gëzojnë pensionet kontributpaguese, pensionet familjare, pensionet

invalide të punës dhe pensionin bazik të moshës. "Me këtë marrëveshje qytetarëve kosovarë, të cilët kanë punuar një kohë të gjatë në Konfederatën Zvicerane, do t'u mundësohet që, pas arritjes së moshës të pensionimit, të kenë të drejtë që këtë pension ta marrin

në Kosovë", ka thënë Reçica. Në anën tjetër, personat të cilët banojnë në Zvicër dhe plotësojnë kushtet për përfitim të ndonjërit pension sipas legjislacionit të zbatueshëm, pala kosovare është e obliguar ta eksportojë pagesën e pensionit nga Kosova në Zvicër.

Kontingjenti gjerman i KFOR-it i dhuron donacion FSK-së

PRIZREN, 2 SHKURT (ER) - Në bazën e KFOR-it gjerman në Prizren të premten është mbajtur ceremonia e dorëzimit-pranimit të një kontingjenti të madh me material sanitar dhe pajisje të tjera të spitalit gjerman për FSK-në. Në këtë ceremoni i pranishëm ishte edhe zëvendësministri i Forcës së Sigurisë së Kosovës, Agim Çeku, komandanti i Forcës së Sigurisë së Kosovës, gjeneralletënant Rahman Rama dhe shefi i Shtabit të KFOR-it, gjeneralbrigade Lawrence Powell. Komandanti i FSK-së, gjeneralletënant Rahman Rama, ka falënderuar kontingjentin gjerman të KFOR-it për mbështetjen e vazhdueshme për FSK-në. "Bashkëpunimin që kemi filluar vite më parë do ta risim edhe më shumë në të ardhmen, që të jemi të pajisur sipas standardeve të NATO-s. Një falënderim të veçantë kam për kontingjentin gjerman dhe Ambasadën Gjermane në Kosovë për dhurimin e këtij donacioni, i

cili për FSK-në ka një rol të veçantë", ka deklaruar Rama. Ndërsa drejtori i Ekipit Këshillues dhe Ndërlidhës të NATO-s (NALIT-it) për FSK-në, gjeneralbrigade Ralf Hoffmann, në fjalimin e tij ka shpalosur kontributin e Gjermanisë në Kosovë që nga koha e luftës në Kosovë, duke theksuar se deri më sot në Kosovë kanë shërbyer më shumë se 50 000 ushtarë gjermanë në kuadër të KFOR-it, të cilët kanë kontribuar në sigurinë e vendit dhe rimëkëmbjen e tij. Komandanti i FSK-së, gjeneral Rama dhe drejtori i NLAT-it, gjenerali Ralf Hoffmann, kanë nënshkruar raportin e dorëzimit-pranimit të donacionit nga kontingjenti gjerman i KFOR-it në Kosovë. Me këtë rast, u tha se ndihma nga Bundesverit gjerman nuk ka munguar asnjëherë për FSK-në dhe ky donacion do ta ndihmojë ngritjen e kapaciteteve mjekësore të FSK-së në nivelin më të lartë. Vlera e këtij donacioni kap shumën prej 140 000 eurosh.



Haziri në Bruksel: Perspektiva evropiane e Kosovës, e paalternativë



BRUKSEL, 2 SHKURT (ER) - Kryetari i Komunitetit të Evropës, Jean-Claude Juncker, ka thënë se "perspektiva evropiane e Kosovës, por edhe e rajonit tonë, është e paalternativë. Në kuadër të këtij angazhimi besoj se shumë shpejt ALDA, sipas kërkesës dhe përkrahjes sime, do t'i mirëpres në gjirin e vet edhe disa komuna nga Kosova, por edhe nga rajoni, si Kosova

ndërmjet institucioneve lokale në nivel rajoni. "Perspektiva evropiane e Kosovës, por edhe e rajonit tonë, është e paalternativë. Në kuadër të këtij angazhimi besoj se shumë shpejt ALDA, sipas kërkesës dhe përkrahjes sime, do t'i mirëpres në gjirin e vet edhe disa komuna nga Kosova, por edhe nga rajoni, si Kosova

Lindore e Maqedonia, si anëtarë të kësaj organizate të rëndësishme të Evropës", ka thënë Haziri gjatë diskutimit në këtë takim në Bruksel. Haziri ka njoftuar se Gjilani shumë shpejt do ta ketë nderin e veçantë që të jetë nikoqire e takimit të radhës të Agjencisë Evropiane për Zhvillim të Demokracisë Lokale (ALDA).

Ministri Beqaj, pjesë e Lutjeve të Mëngjesit në ShBA

Ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, javën e ardhshme do të qëndrojë në ShBA, ku do të marrë pjesë në Lutjet e Mëngjesit. Po ashtu, ai do të takojë përfaqësues të Departamentit të Shtetit

EPOKA E RE **Arbisa SHEFKU**

PRISHTINE, 2 SHKURT - Ministri i Ministrisë së Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, javën e ardhshme do të udhëtojë në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (ShBA), ku do të marrë pjesë në Lutjet e Mëngjesit, si dhe do të ketë takime të rëndësishme me qëllim të thellimit të bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave dhe mbështetjes

amerikane në fushën e inovacionit dhe ndërmarrësisë. Ministri Beqaj gjatë qëndrimit në ShBA do ta vizitojë Universitetin "James Madison", ku do ta takojë presidentin e këtij universiteti, në veçanti Departamentin për Inovacion dhe Ndërmarrësi. Ai do të ketë takime shumë të rëndësishme edhe me përfaqësues të Departamentit Amerikan të Shtetit, Bankës Botërore, USAID-it, si dhe me përfaqësues

të Odës Ekonomike të Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Ministri Beqaj gjatë vizitës në ShBA do ta promovojë Ministrinë e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, do të kërkojë mbështetje në fushën e konsulentëve dhe në aspekte të tjera që do të ndihmonin në realizimin e objektivave të kësaj ministrie, si dhe do t'i marrë përvojat amerikane për funksionimin e qendrave të inovacionit dhe ndërmarrësisë.



Ministria e Inovacionit i premtan përkrahje financiare 'Prishtina Hackerspace'-s

PRISHTINE, 2 SHKURT (ER) - Në vazhdim të vizitave që ministri i Inovacionit dhe Ndërmarrësisë, Besim Beqaj, po ua bënë ndërmarrjeve inovative dhe komunitetit të kësaj fushe, ka qëndruar në ambientet e "Prishtina Hackerspace". Ministri Beqaj është njoftuar me aktivitetet e kësaj ndërmarrje, për fushëveprimtarinë dhe ambiciet e saj për të ardhmen, me ç'rast ka thënë se "Prishtina Hackerspace" është një hapësirë e mirë ku të rinjtë dhe të rejtat mund të gjejnë vendin ku mund ta shprehin

shpirtin e tyre kreativ dhe inovativ. "Të rinjtë dhe të rejtat që i pashë këtu sot që punojnë në kushte jo të mira, të cilat normalisht duhet të përmirësohen në të ardhmen me bashkëpunim. Kjo veprimtari mund të jetë e ardhmja ekonomike digjitale, ajo që ne si ministri po tentojmë ta promovojmë. Rinia jonë me kapacitetet që ka do të jetë baza kryesore e përfaqësimit jashtë vendit", ka thënë ministri Beqaj. Ndërsa Besfort Guri, bashkëthemelues i "Prishtina Hackerspace", u shpreh i kënaqur

me vizitën e ministrit Beqaj. "Prishtina Hackerspace ekziston si entitet për rreth tre vjet dhe është një hapësirë eksperimentale e cila ndihmon të rinjtë për zhvillimin në aspektet teknologjike dhe inovative. Bashkë vizituar hapësirat e 'Prishtina Hackerspace' dhe morëm premtime që Ministria e Inovacionit dhe Ndërmarrësisë do të na përkrahë financiarisht në aktivitetet tona, në veçanti për organizimin e konferencës 'Freedom Software Kosova', ka thënë Guri.

Ambasadori sloven vlerëson Kosovën në hapat e implementimit të MSA-së

PRISHTINE, 2 SHKURT (ER) - Ministri i Financave, Bedri Hamza, ka pritur të premtan në takim ambasadorin e Sllovenisë në Kosovë, Bojan Bertoncelj, me të cilin ka diskutuar për vazhdimin dhe thellimin e bashkëpunimit ndërmjet dy vendeve, sidomos për shkëmbimin e përvojave në fushën e financave publike, si dhe për vizitën që pritet të bëjë ministri Hamza në Slloveni gjatë javës së ardhshme. Ministri Hamza gjithashtu e ka njoftuar ambasadorin Bertoncelj për zhvillimet buxhetore, për prioritetet e Qeverisë dhe planin e adresimit të sfidave në fushën e ekonomisë për ruajtjen e rritjes ekonomike dhe ruajtjen e

indikatorëve makro fiskalë. Po ashtu, e ka njoftuar ambasadorin edhe për përkushtimin në fuqizimin e sektorit privat si bartës të rritjes ekonomike në vend dhe hapjes së vendeve të reja të punës. Ndërsa ambasadori sloven në Kosovë, Bojan Bertoncelj, ka falënderuar ministrin Hamza për bashkëpunimin si dhe për progresin e arritur të Kosovës në fushën e financave, në veçanti në hapat e saj për implementimin e MSA-së. Me këtë rast, ambasadori Bertoncelj ka shprehur gatishmërinë e shtetit sloven për ta përkrahur Kosovën në proceset integruuese të saj drejt Bashkimit Evropian.



7.2 milionë deklarata të shkarkuara përmes E-Deklarimit



PRISHTINE, 2 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) në vitin 2011 ka lansuar projektin më të madh elektronik të quajtur E-Deklarimi. Kjo platformë fillimisht ka qenë në dispozicion për bizneset që janë të kategorizuara në Drejtorinë e Tatimpaguesve të Mëdhenj, ndërsa për pjesën tjetër të tatimpaguesve mundësia e përdorimit të E-Deklarimit ka qenë që nga fillimi i vitit 2012.

"Deklarimi elektronik -EDI është mënyrë moderne (e avancuar), e shpejtë dhe e thjeshtë për ta deklaruar tatimin. Ky sistem mundëson dhe krijon një llogari online të tatimpaguesve me ATK-në, ku mund të plotësohen dhe deklarohen: deklarimi dhe pagesa e të gjitha tatimeve dhe kontributeve pensionale, gjerimi i fletëpagesës për borxhet e pashlyera që nga viti 2011, pasqyra mbi gjendjen e

tatimpaguesit që nga viti 2011, gjerimi i vërtetimit tatimor për biznese, raportimi i blerjeve mbi 500 euro, caktimi i personit të autorizuar, ndryshimi i profilin dhe fjalëkalimit, kontrollimi i historisë dhe bilancit tatimor, kërkesa për ndihmë etj. Oë nga lansimi i kësaj platforme elektronike e deri më tani numri i deklaratave të shkarkuara është 7.2 milionë", është bërë me dije në njoftimin e ATK-së.

Gjiganti 'Shell' vjen në Kosovë, nënshkruan marrëveshje me 'AL Petrol'-in

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Kompania më e madhe në botë për derivate "Shell" të premtën ka zyrtarizuar nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit me kompaninë "AL Petrol". Konkretisht rrjeti i "AL Petrol"-it do të rimerthohet në "Shell" gjatë muajit prill të këtij viti. Përfaqësuesit e të dyja këtyre kompanive kanë bërë me dije se sa i rëndësishëm është lajmi që "Shell"-i me produktet e saj tani do të jetë në Kosovë, duke i furnizuar qytetarët e vendit me derivate cilësore dhe me një gamë të gjerë të produkteve të saj. Me këtë rast, drejtori i "AL Petrol"-it, Latif Kryeziu, ka thënë se deri më tani i kanë furnizuar qytetarët e Kosovës për 30 vjet me radhë me cilësinë më të mirë të mundshme, në rreth 70 pika. "Sot mburremi që kemi arritur ta sjellim në Kosovë një brend siç është 'Shell', që do të ofrojë

çmime të përshtatshme për tregun e Kosovës", ka thënë Kryeziu. Edhe menaxheri i kompanisë "Shell" për Evropën Juglindore, Vim Riegman, ka thënë se të gjitha pikat e "AL Petrol"-it do t'u përbahen standardeve të "Shell"-it. "Të gjitha pikat do të ofrojnë derivate kualitative, lubrifikant kualitativ, oferta të përshtatshme dhe shërbime kualitative. 'Shell'-i është i pranishëm në 80 vende të botës dhe u shërben 30 milionë klientëve çdo ditë", është shprehur Riegman. Ai ka konfirmuar se do ta sjellin edhe produktin më të ri të "Shell"-it, që është "V Power", produkt me të cilin furnizohet edhe partneri i tyre afatgjatë në Formula 1, "Ferrari". "Shell"-i është kompania e derivateve më e madhe në botë që ka mbi 43 000 pika në pesë kontinente me rreth 30 milionë konsumatorë në ditë.



Ministri Lekaj: Të gjitha fluturimet nga aeroporti janë të sigurta



Ministri i Infrastruktūrës, Pal Lekaj, ka demantuar raportimet se KFOR-i t'i ketë marrë përgjegjësitë në kullën e trafikut ajror në Aeroportin e Prishtinës "Adem Jashari" për shkak të sigurisë. Ai ka thënë se Ministria e Infrastruktūrës e siguron opinionin se të gjitha fluturimet nga Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" janë të sigurta

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 2 SHKURT - Ministri i Infrastruktūrës, Pal Lekaj, ka demantuar raportimet se KFOR-i t'i ketë marrë përgjegjësitë në kullën e trafikut ajror në Aeroportin e Prishtinës "Adem Jashari" për shkak të sigurisë. Lekaj përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar se të gjitha fluturimet nga Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" janë të sigurta. Ministri Lekaj ka theksuar se Aviacioni Civil në Republikën e Kosovës zhvillohet në bazë të ligjeve në fuqi dhe në pajtim me standardet e ONAC dhe të Bashkimit Evropian. "Ofrimi i shërbimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës bëhet nga ASHNA dhe nën mbikëqyrje

të AAC-së. Të dy këto autoritete janë audituar nga ekspertët e BE-së në kuadër të Marrëveshjes për Hapësirën e Përbashkët Evropiane të Aviacionit (ECAA), pjesë e së cilës është edhe Kosova që nga viti 2006. Prandaj, Ministria e Infrastruktūrës e siguron opinionin e gjerë se të gjitha fluturimet nga Aeroporti Ndërkombëtar "Adem Jashari" janë të sigurta. Është i pavërtetë dhe i pavend lajmi se KFOR-i i ka marrë përgjegjësitë në kullën e trafikut ajror për shkak të sigurisë. KFOR-i dhe autoritetet vendore kanë kontakte të vazhdueshme dhe raporte të shërbimeve me qëllim të ofritit sa më të sigurt të shërbimeve në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës", ka thënë ministri i Infrastruktūrës, Pal Lekaj.

"Vala", pesë superprodukte të kombinuara

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Telekom i Kosovës, "Vala", ka lansuar një pako me superprodukte të kombinuara me çmime dhe oferta tejet atraktive. Kjo gamë e produkteve më të reja, që përfshin një pako të kombinuar për të gjithë konsumatorët, është tejet e favorshme dhe e përshtatshme për çdo lloj grupmoshe përdoruesish. "Bëhet fjalë për atë kategori konsumatorësh me parapagim që

zakonisht flet shumë dhe përdor më pak internet dhe, po ashtu, edhe për të gjithë ata përdorues që shfrytëzojnë shumë internet e të cilët kanë të përfshira shumë minuta dhe SMS brenda një pakoje, respektivisht brenda një oferte. Me këtë superofertë të fundit prej pesë superpakove të kombinuara për të gjithë konsumatorët Prepaid do të përfitojnë së tepërmi shfrytëzuesit e internetit përmes

pakove 10GB internet duke përfutur edhe 300 minuta dhe 300 SMS", është bërë me dije në komunikatën e Telekomit të Kosovës. Me moton e këtij superprodukti "Je përdorues i madh interneti, hiç mos e nal", "Vala" ka për synim t'i përbushë në këtë mënyrë kërkesat e vazhdueshme të të gjithë konsumatorëve për internet të shpejtë, sasi dhe cilësor.

FOL SA TË DUASH
HIÇ MOS E NAL

FOL S

150MIN
150SMS
1000MB

PAKOT E KOMBINUARA

2.99€

Validiteti 15 Ditë
Aktivizohet duke dërguar SMS në 80000 nga telefoni FOL S

Lladrovci pranon ekzemplarën e parë të librit 'Illegal viteve shtatëdhjetë'



DRENAS, 2 SHKURT (ER) - Nën kryetari i Komunës së Drenasit, Gani Sylaj, njëherësh autor i librit "Illegal viteve shtatëdhjetë", i ka dhuruar ekzemplarën e parë të këtij libri, kryetarit të kësaj komune, Ramiz Lladrovci.

Kryetari Lladrovci ka përgëzuar nënkryetarin Sylaj për angazhimin e punës për botimin e këtij libri që, sipas tij, flet për veprimtarinë ilegale të viteve të shtatëdhjeta në Kosovën e push-tuar nga ish-Jugosllavia.

Lladrovci e ka inkurajuar autorin ta vazhdojë veprimtarinë për të nxjerr në dritë edhe libra të tjerë për t'ua treguar gjeneratave të reja pushtimin e egër. Ndërsa Gani Sylaj ka theksuar se ka nderin që ekzemplarën e parë të këtij libri t'ia dhurojë Lladrovci.

Gani Sylaj ka përfunduar edhe vëllimin e dytë të librit, i cili do të jetë shumë shpejt në duart e lexuesve, po ashtu është duke punuar edhe për vëllimin e tretë të librit që i takon kësaj periudhe.

ATK-ja tejkalon planin e të hyrave

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) vitin 2018 e ka vazhduar përkushtimin për mbledhjen e të hyrave të përcaktuara nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Të hyrat për muajin janar 2018 kanë shënuar rritje për 6 milionë euro ose 13 % më shumë se muaji janar i vitit 2017.

Janar është 51.4 milionë euro, ndërsa në raport me planin janë realizuar të hyra në vlerë prej 2.6 milionë eurosh më shumë ose mbi 5.3 %. ATK-ja ka njoftuar se është realizuar 12 % e planit të të hyrave për vitin 2018. "Rritja e të hyrave është rezultat i ngritjes së nivelit të përmbushjes vullnetare të tatimpaguesve, punës së palodhshme të zyrtarëve të

administratës tatimore, modernizimit të shërbimeve tatimore dhe rritjes së komunikimit me tatimpaguesit. Po gjatë kësaj periudhe janë mbledhur mbi 9.9 milionë euro kontribute pensionale, pra gjithsej të hyra gjatë kësaj periudhe raportuese (tatimet dhe kontributet pensionale) janë në vlerë mbi 61.3 milionë euro", është thënë në njoftimin e ATK-së.



Mbahet takimi për identifikimin e masave rreth planit të mobilitetit

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) - Drejtori për Planifikim Strategjik dhe Zhvillim të Qëndrueshëm, Genc Bashota, ka mbajtur takime me anëtarët e Këshillit Drejtues dhe grupit punues, në të cilat janë prezantuar punët e deritanishme dhe hapat e mëtejshëm për Planin e Mobilitetit të Qëndrueshëm Urban për Prishtinën.

Bashota ka bërë me dije se janë identifikuar mbi 100 masa infrastrukturore, operative dhe organizative, bazuar në analizat, strategjitë dhe konceptet e planit të mobilitetit. "Këto masa do të rishikohen dhe filtrohen në mënyrë që të përmbushen objektivat tashmë të përcaktuara në fazat e mëherëshme të planit, ku do të nxirren top 20 masat më të zbatueshme", ka



thënë ai.

Përmes modelit të trafikut po testohen skenarë të ndryshëm duke kombinuar rrjetet

strategjike të transportit në raport me zhvillimin e qytetit si dhe trendët demografikë dhe rritjet e mundshme ekonomike.

Në Deçan arrestohen gjashtë persona të dyshuar për vjedhje

DEÇAN, 2 SHKURT (ER) - Njësisë e Hetimeve e Stacionit Policor në Deçan, në bashkëpunim me njësitë e tjera dhe në bashkëpunim me qytetarët e Deçanit, ka arrestuar një grup të personave të dyshuar, të cilët kanë kryer disa vjedhje në territorin e Deçanit. Këto vepra penale janë kryer në vitin 2016/2017 dhe më herët.

"Vjedhjet kanë ndodhur në shtëpi, banesa dhe dyqane afariste të qytetarëve të Deçanit me rrethinë", është bërë me dije në komunikatën e policisë rajonale të Pejës. Në total kanë



qenë 21 raste të raportuara të këtyre veprave që dyshohet se janë kryer nga ky grup personash. Gjithashtu, nga të dyshuarit në këto raste janë sekuestruar edhe mjete të tjera të kundërligjshme, armë automatike, revole e municione përcjellëse dhe pushkë ajrore.

Fermerët e Therandës të interesuar për skemën e granteve nga MZHR-ja

THERANDË, 2 SHKURT (ER) - Në sallën e Asamblesë Komonale në Therandë të premtën është organizuar sesioni informues për skemën e granteve "Programi i zhvillimit rajonal të balancuar" të Ministrisë së Zhvillimit

Rajonal (MZHR). Nën kryetarija e Komunës së Therandës, Mihrije Suka, ka ftuar të pranishmit të aplikojnë për ta fituar ndonjërin nga tre lotet sa janë gjithsej. Për rëndësinë e këtyre granteve ka folur edhe zëvendësiministri i

MZHR-së, Musa Cena, i cili ka thënë se kanë disa fonde të cilat do t'i fitojnë komunitat. "Fondet që do t'i ndajë kjo ministri nuk janë edhe aq të mëdha, por ky është një hap që do të ndikojë që MZHR-ja ta zgjerojë veprimtarinë", ka deklaruar Cena.



Tensione në horizont, në rast se Kosova nuk përfshihet në strategjinë e BE-së



Nga Bekim ÇOLLAKU

Brenda një jave Komisioni Evropian do ta bëjë publike strategjinë e paralajmëruar për Ballkanin Perëndimor. Ky është një hap i ri i rëndësishëm për BE-në, i cili ka nxitur shpresë, por edhe hidhërim pothuajse në të gjitha vendet e rajonit, të cilat aspirojnë t'i bashkohen BE-së. Viti 2018 mund të jetë vendimtar për marrëdhëniet e BE-së me Ballkanin Perëndimor. Përveç aprovimit të Strategjisë për Ballkanin Perëndimor, presidenca e BE-së, e udhëhequr nga Bullgaria, e ka vënë Ballkanin Perëndimor si një nga prioritetet e saj. Ne jemi optimistë, sepse të gjithë vijmë nga i njëjti rajon dhe pak a shumë kemi aspirata të njëjta ndaj BE-së, prandaj duam ta shohim hapin e ardhshëm në rrugën tonë evropiane duke dhënë rezultate. Megjithatë, në të njëjtën kohë ne jemi të shqetësuar, sepse konsiderojmë se është thelbësore që ne të trajtohem në mënyrë të barabartë në kuadër të strategjisë dhe të na ofrohet e njëjta perspektivë. Çdo diskutim për shtetet që prijnë, pashmangshëm i bën të

tjerat të mbetura mbrapa. Ne e dimë që sa më e fuqishme të jetë perspektiva e BE-së, aq më shumë do të ketë pranueshmëri në vendet tona për t'i shtyrë përpara reformat politike, ekonomike dhe sociale, të cilat janë të domosdoshme, por jo edhe aq populiste. Në rast se Komisioni Evropian dëshiron të shohë përpjekje serioze për reforma në rajonin tonë, atëherë duhet që të sigurojë një perspektivë të fuqishme dhe të përbashkët për integrimin e Ballkanit Perëndimor në BE.

Deri më tani gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor janë trajtuar si një rajon i vetëm. Të gjitha vendet kanë Marrëveshjet e Stabilizim Asociimit me BE-në dhe të gjitha janë të përfshira edhe në marrëveshje të tregtisë së lirë. Disa nga vendet e kanë statusin e kandidatit për anëtarësim, të tjerat janë kandidatë potenciale, por e rëndësishme është që të gjithave u është ofruar shansi i barabartë për anëtarësim në samitin e Selanikut në vitin 2003. Presidenca e BE-së, e udhëhequr nga Bullgaria, ka marrë përsipër organizimin e samitit të parë për Ballkanin Perëndimor me pjesëmarrjen e 28 shteteve anëtare, që pritet të mbahet 15 vjet pas samitit të Selanikut. Prandaj, është vendimtare që Strategjia e Komisionit Evropian dhe Samiti i Sofjes, ta ofrojnë per-

spektivën e njëjtë të anëtarësimit për gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor. Njësoj sikur ishte simbolik zgjerimi i vitit 2004 me anëtarësimin në bllok të shteteve ish-komuniste të Evropës Qendrore dhe asaj Lindore, ashtu do të ishte edhe zgjerimi i BE-së me anëtarësimin e të gjitha shteteve të Ballkanit Perëndimor. Shtetet që kanë qenë armiq të ashpër me njëri-tjetrin vetëm 20 vjet më parë, janë të gatshëm t'a lënë këto probleme të së kaluarës. Qëllimi është të mos lejohe bartja e ndonjë çështje të komplikuar politike brenda unionit në kohën kur të ndodhë anëtarësimi. Dhe mënyra më e mirë për të arritur një gjë të tillë është që anëtarësimi të ndodhë në të njëjtën kohë dhe në bllok.

Përpjekjet për ta integruar rajonin përpara anëtarësimit në BE janë duke vazhduar me qëllim që të gjashtë ekonomitë respektive të përgatiten për t'i rezistuar presionit kur të bëhen një nga 33 anëtarët e BE-së. Ashtu sikur jemi dëshmitarë të vështirësive në punën e Zonës Ekonomike Rajonale, pengesat strukturore dhe politike për integrimin e mëtejshëm janë mjaft të përhapura dhe serioze. Rruga e vetme nëpërmjet së cilës ne do të mund t'i zgjidhim problemet tona dhe vërtet ta përqafojmë konceptin e marrëdhënieve të mira fqinjësore, është një perspektivë e përbashkët për antarësim në BE,

në kuadër të së cilës fatet tona janë të lidhura me njëri-tjetrin. BE-ja duhet të mësojë nga gabimet e bëra në të kaluarën dhe nuk duhet të lejojë një shtet që të anëtarësohet, pastaj t'i mundësojë atij shteti që t'i bllokojë anëtarësimet e tjera vetëm për shkak të armiqësisë politike.

Dialogu i lehtësuar nga BE-ja ndërmjet Kosovës dhe Serbisë duhet të futet në fazën për fundimtare dhe nuk ka pritje tjetër të mundshme përveç njohjes së pavarësisë së Kosovës nga Serbia. Natyrisht, do të duhet të bëhen kompromise nga të dy shtetet me qëllim që të arrihet marrëveshja historike për paqe dhe pajtim. Në të njëjtën kohë, nuk mund të mendohet se do të mund të vazhdohet me të njëjtën status quo duke pasur pesë shtete anëtare të BE-së, të cilat nuk e njohin pavarësinë e Kosovës vetëm për shkak se Serbia refuzon ta njohë realitetin faktik dhe të shkëputet nga e kaluara. Kosova nuk do të mund të anëtarësohet në BE në rast se nuk i normalizon marrëdhëniet me Serbinë. Ndërsa BE-ja deri më tani ka marrë vendime të mençura duke vendosur kushtetëz të veçantë për anëtarësimin e Serbisë në BE vetëm pas normalizimit të marrëdhënieve me Kosovën. Kosova është tërësisht e përkushtuar për zbatimin në mirëbesim të të gjitha marrëveshjeve të arritura deri më

tani, duke përfshirë marrëveshjen për themelimin e asociacionit të komunave me shumicë serbe, në përputhje me vendimin e Gjykatës Kushtetuese të Kosovës. Homologët tanë nga Serbia duhet t'i zbatojnë marrëveshjet e arritura për energjinë dhe njohjen e diplomave dhe t'u japin fund përpjekjeve të tyre për ta bllokuar anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare, siç janë UNESCO dhe INTERPOL.

Me qëllim që të sigurohen stabiliteti, paqja dhe zhvillimi politik dhe ekonomik i shteteve të Ballkanit perëndimor, BE-ja duhet të sigurojë jo vetëm një qartësi të perspektivës evropiane për Ballkanin perëndimor, por edhe qasje të barabartë për të gjithë. Kjo strategji duhet të jetë politike dhe jo vetëm një dokument veçse teknik. Nëse një perspektivë e qartë për anëtarësim në BE do t'u ofrohet në mënyrë të barabartë të gjithëve, kjo do t'i ndihmonte të gjashtë vendet që t'i tejkalojnë problemet serioze bilaterale, në të kundërtën ajo vetëm sa mund t'i ngrehë tensionet në rajon, në rast se disa shtete do të ecin përpara, ndërsa të tjerat do të lihen mbrapa.

(Bekim Çollaku është ish-ministër për Integrim Evropian i Kosovës dhe tani është shef i Stafit të presidentit të Kosovës. Ky shkrim është botuar në gazetën evropiane "Euobserver")

Presidenti Thaçi priti një delegacion nga Ulqini

PRISHTINË, 2 SHKURT (ER) -

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka pritur të premten në takim një delegacion nga Ulqini, i kryesuar nga Nazif Cungu, kryetar i Ulqinit, dhe në përbërje të Genci Nimanbegut, nënkryetar i Kuvendit të Malit të Zi, si dhe nga Faik Nika, nënkryetar i Forcës së re Demokratike.

Në takim u fol për zhvillimet politike në Mal të Zi, me theks të veçantë për subjektet politike shqiptare, të cilat luajnë rol konstruktiv në skenën politike si në nivel lokal, po ashtu edhe në atë

qendror.

Më tej u theksua nevoja e koordinimit më të mirë të faktorit politik shqiptar, për të qenë i pranishëm dhe i reprezentueshëm në asamblatë komunale ku ka më shumë popullatë shqiptare.

Presidenti Thaçi ka garantuar delegacionin nga Ulqini për bashkëpunim të vazhdueshëm midis subjekteve politike të shqiptarëve të Malit të Zi dhe institucioneve të Kosovës, në favor të krijimit të politikave që forcojnë Malin e Zi si shtet demokratik dhe anëtar i NATO-s.



HASHIM, MOS U KËRCËNO, SE ASKUSH MË NUK TA KA FRIKËN!



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA

Dy kërcënues kujdestarë: Janë dy kërcënues kujdestarë që tërë kohën më rrinë si shpata e Demokleut mbi qafën time dhe nuk e di kurrë se ku do të përfundojë koka ime, në Prishtinë apo Bruksel ose Uashington. Disi kam filluar të ndihem si Ali Pashë Tepelena: trupin në Prishtinë, kokën në Bruksel. Presidenti i Republikës së Kosovës, Shkëlqesia e Tij, zotëri Hashim Thaçi, gjithmonë kur i vjen veja të dalja emergjente, si Papa Françesku që në enciklikën e tij i drejtohet botës urbi et orbi, Hashimi i kërcënon ndërkombëtarët me destabilizim të situatës dhe paqëndrueshmëri afatgjatë. Sidomos kur i kalon vagoni i fundit për liberalizim të vizave i kujtohet se në Kosovë paska pasur luftë dhe ka pasur shumë viktima që kanë mbetur të padënuara. Atëherë i kujtohet se Serbia paska bërë krim dhe gjenocid në Kosovë e që vetëm pas një jave e përqafon Vuçiqin si ta kishte djallë teze. Më kujtohet se kur duhej të votohej Gjykata Speciale, më shumë angazhohej presidenti Thaçi për të se vetë Dik Marti. Njeriu i drejtë dhe i përgjegjshëm kërkon drejtësi për viktima pa bërë dallime etnike, fetare, racore, gjinore etj. sikur edhe përgjegjësi për ata që kanë bërë krime, pa bërë asnjë dallim. Njeriu pa ndjenja shpirtërore, i zhveshur nga çdo ndjenjë përgjegjësie, kërkon drejtësi vetëm për viktima e "veta", kurse nuk i interesojnë viktima e tjera. Viktimat e "veta" i mbron jo se ndien dhembshuri, por i përdor për konsum dhe përfitime politike. Njeriu që ka mungesë të theksuar të përgjegjësisë, ata që kanë bërë krime nga radhët e veta i konsideron si patriotë, kurse kundërshtarët kriminelë. Nuk ka asgjë më e ulët se kur krimet arsyetohen me sloganin se: "Lufta jonë është 100 % e pastër sepse kemi bërë luftë të drejtë". Është dallim i madh midis luftës së drejtë dhe luftës së pastër. Lufta e drejtë, e lufta

e së lavdishmes Ushtri Çlirimtare e Kosovës ka qenë 1 000 % e drejtë, nuk do të thotë se ka qenë 100 % e pastër. Ky është mendimi dhe ky është qëndrimi im që e kam pasur gjatë dhe pas përfundimit të luftës e që e kam të paluhatshëm edhe sot. Në këtë kontekst e kam kundërshtuar Gjykatën Speciale, jo se dua t'i amnistoj ata që kanë kryer krime eventuale, por se kam vlerësuar, në bazë të informatave që i kam, se kjo Gjykatë është e padrejtë sepse nuk siguron drejtësi për të gjitha viktimat, por siguron drejtësi vetëm për viktima joshqiptare (serbe, rome etj.) si dhe ato shqiptare që kanë bashkëpunuar me okupuesin. Kjo është tabloja e viktimave që do të fitojnë drejtësi e që, nëse trajtohen 10-30 raste në këtë gjykatë, i bie se viktimat që do të fitojnë drejtësi nuk do të jenë më shumë se 0.3%. Në aspektin e realizimit të drejtësisë për viktima edhe ky 0.3 % është pozitiv, po si do të realizojmë drejtësi për 99.7 % të viktimave dhe si do të kërkojmë përgjegjësi penale për kriminelët? Drejtësia për viktima është hijë nëse kriminelët nuk i sillni para drejtësisë. Nëse kjo Gjykatë Speciale e ka këtë mision për të ndarë drejtësi selektive dhe për të ndarë përgjegjësi selektive, në asnjë rrethanë nuk do të pranoja dhe me asnjë kusht nuk do ta votoja. As me kushtin e jetës e lëre më për një karrige të pshurrit apo përfitime që nuk mund t'i gëzosh dhe të cilat pashmangshëm të mbesin në fyt. Është shumë e pamoralshme që njëherë e voton pastaj e ç'voton. Këta deputetë janë hijë dhe nuk janë për asgjë! Deputetët që miratojnë ligje për një shtet, ta bëjnë punën të bëjnë hajgare me votuesit dhe qytetarët, duke luajtur guxhash me Gjykatën Speciale nuk e meritojnë as respektin që shprehet edhe në miligram. Deputetët që bëhen kukull e liderit apo liderëve e që pastaj shndërrohen në pleshta, s'ka ç'të thuash për ta. Nuk shkon bashkë edhe t'ua tregosh muskujt faktorëve vendimarrës ndërkombëtarë e pastaj t'i ulesh brekët para tyre. Kush e ka në mend të parë interesin kombëtar dhe shtetëror, pa asnjë hezitim e gëlltit helm në vend të mjalit. Këtë sakrificë të vetëflilimit, sikur që e bëjnë Sokrati apo Seneka, për të vërtetën nuk e kërkon askush nga deputetët apo politikanët

tanë. Por, nuk kanë të drejtë që nga ne të kërkojnë sakrifica kurse ata të përqyren para "mikut" ndërkombëtar. Edhe ata që janë gjysmë të informuar kanë qenë të sigurt se Gjykata Speciale nuk mund të shfuqizohet. Ka qenë një lojë mirë e koordinuar midis disa politikanëve kosovarë dhe një pjesë të ndërkombëtarëve. Situatat dhe skenat si: "thikë prapa shpine, pabesi, rrezikim i Kosovës, humbja e përkrahjes ndërkombëtare, rrezikim i rendit ndërkombëtar... dhe budallallëqe të tjera" kanë qenë për përdorim të jashtëm dhe të brendshëm dhe prej kësaj pune nuk pati dhe nuk ka asgjë. Në një vend normal, shfuqizimi i një ligji për themelimin e një Gjykate apo Shtëpie Publike (i njohur si puf për përdorim ndërkombëtar), është e drejtë legale dhe legjitime. Të ne kjo e drejtë u konsiderua sikur të ishte fundi i botës. Kurrë nuk jam brengosur për këtë sepse e kam pasur të qartë fundin duke i njohur mirë politikanët, por edhe deputetët që, edhe flajël, por edhe pordhët i kanë të forta. Për punë mos të flasim. Tash, Hashimi kur ndërkombëtarët thanë se ka iku treni për Kosovën për liberalizim të vizave dhe për integritet evropian, e nxori nga brezi armën e mbushur me pordhë, duke i kërcënuar ndërkombëtarët me destabilizim të situatës. Askush nuk po ia ka frikën më Hashimit. Madje as unë që deri dje jam përsërrur në tëllina me të dëgjuar kërcënimet e Hashit. Merreni me mend deri ku ka ardhur puna! Viza dhe Mona Liza: Kur Ramush Hardinajt nuk iu dha viza për Amerikë, LDK-ja vetëm sa nuk e shpalli ditë zie kombëtare dhe shtetërore. Mandej erdhi dhe viza angleze dhe këta të LDK-së dhe mendermethënë shoqëria civile përjetuan orgazëm nga kënaqësia. Një i arratisur nga shoqëria civile deklaroi publikisht, mbase për ta poshtëruar Ramushin, se "po të ishte në vend të tij nuk do të rrinte as dy muaj si kryeministër, pasi i qenka refuzuar viza...". Tash, pasi e mori vizën britanike dhe kur ta merr vizën amerikane, do të thonë se: "...u palua Ramushi, prandaj e mori vizën...". Ramushi po bën gabime. Do të bëjë gabime edhe në të ardhmen. Shumë herë nuk jam pajtuar me të. Jemi ballafaquar rëndë, por Ramushin e kam

vlerësuar shumë për sakrificën dhe luftën e madhe që e ka bërë, falë së cilës e gëzojnë lirinë dhe të drejtën të shajnë e të fyejnë edhe ata që deri dje kanë qenë pjesë e grazilit të Jugosllavisë dhe të Serbisë. Për mua ka qenë e papranueshme nderimi me një minutë heshtje për Oliver Ivanoviqin, i dënuar dhe i rikthyer për rigjykim për krime ndaj shqiptarëve. Të mos gjendej asnjë deputet shqiptar që do ta kundërshtonte këtë veprim të pashembullit për së keqi, kjo është brengosja ime. Mirëpo, Ramushi dhe të gjithë ata që kanë luftuar për lirinë time dhe të gjithë juve që jeni mosmirënjohës dhe përbuzës mbetet dhe mbeten përmendore të përjetshme. Për luftën dhe sakrificën që e kanë bërë! Në këtë kontekst e konsideroj si përpjekje të kotë Baton Haxhiun që dëshiron ta zhveshë Albin Kurtin nga vlerat kombëtare, patriotike, intelektuale dhe politike. Ta bësh krahasimin midis Albin Kurtit dhe Baton Haxhiut sa iu përket këtyre vlerave është si ta krahasosh elefantin me pleshtin. Të gjithë ne e kemi një të kaluar, personale dhe familjare. Albin Kurti e ka një të kaluar të sqaruar, Batoni e ka një të kaluar me shumë hije. E ka shumë të pasqaruar. Derisa akuzat e Albinit ndaj Batonit kanë qenë shumë të qarta, përgjigja e Batonit, jo që nuk ka qenë përgjigje ndaj akuzave të Albinit, por vetëm sa i ka bërë më të dendura hijet nga e kaluara e Batonit. Përgjigjet e gjata apo litantë "intelektuale" të Batonit, vetëm sa e kanë bezdisur lexuesin i cili nuk ka besuar fare në ato përgjigje. Kam përshtypje që as Batoni nuk ka besuar në atë çka ka shkruar. Kjo është vetëm se për të nisur një ballafaqim me të kaluarën. Jam i gatshëm të bëhem pjesë e debatit, ndonëse me Albinit moti i kemi ndarë rrugët, kurse me Batonin kurrë nuk kemi qenë në të njëjtën rrugë. Kositja e gjerë e Behgjet Pacollit: Begja fort është trimëruar. Të gjithëve po u kërcënohet. Ambasadorëve (22) që do t'i kthejë prapa. Politika e Jashtme e Kosovës gjithmonë ka qenë në duar të gabuara. Enveri e ka masakruar ministrin duke e dënuar me vdekje, ndërsa Begja po e dërgon drejt ekzekutimit me gjyotinë. Hashimi ministrinë për punë të jashtme e ka përdorur si

pushim midis dy akteve sekulare dhe për ta pajisur me gardërobë Bekim Çollakun. Behgjet Pacolli i paska investuar 80 000 ojro në rinovimin e hapësirës së MPJ, kuptohet prej donacioneve të Buxhetit të Kosovës (humanist i madh është Begja...), kurse Ambasaden e Kosovës në Uashington e ka lënë pa ujë për pije, kurse tavolinat dhe karigjet ku priten delegacionet dhe palët u ngjajnë mobileve që hedhen në rrugë. Aso mobile nuk mund të gjeni as në Guinea Bisao ku ishte Begja për ta rikthyer njohjen nga ky shtet. Po mos ta njihje Guinea Bisao Kosovën, do të kishte marrë fund puna jonë. Begja është hajgarexhi i madh, luan koqe me kënd të mundet. Së voni doli me propozim i cili nuk dallon fort nga ai i Daçiqit apo Vulinit se: "Serbia nuk e ka të domosdoshme ta njohë pavarësinë e Kosovës...". Begja jarani, fol në emër tëndin e jo në emër të Behxhetit. Kam përsërrur afërsisht 9 vjet (5.5 vjet në vetmi) sikur që jam dhjerë po aq kohë në oturakët e ndryshkur të prodhuar në vitet 1945-48, jo për atë çka deklarove, por për atë për çka i flijuan Baca Adem Demaçi, komandanti legjendar Adem Jashari dhe heronjtë që u sakrifkuan për këtë që t'i po e keqpërdorë politikisht. Mbaje për ty Baca Adem Demaçi dhe komandanti legjendar Adem Jashari nuk paraqesin asgjë, por për mua dhe shumë të tjerë janë fryma dhe kuptimi i jetës. Ndal, Begjo! Kërcënim i dytë: Çdoherë kur e shoh para medieve Rrahman Jasharin më kap frika dhe tmerri. Gjithmonë kërcënohet me greva dhe kryengritje të SBASHK-ut. Jo për libra dhe arsim më të mirë, por për rritje të pagave. Tash në fillim, njëri prej këtyre të dyve do të jetë exheli im, ja Hasha, ja Rrahmani. Hasha do të më prishë me "miqtë" ndërkombëtarë që aq shumë i dua dhe aq shumë i respektoj. Që nga koha e Dellit e këndej, kurse Rrahmani do me prishë me miqtë vendorë, Hashimin, Kadrushin, Zejdushin etj... Duket se pas një kohe do ta dëgjoni këngën e kënduar nga kori i burrave dhe i grave i ansambllit folklorik nga Gjylekari dhe Muqibaba për mua: "Trupin në Prishtinë o, kokën në Bruksel, të vranë o të vranë, or Behxhet këta...".

Tillerson, turne në Amerikën Latine

WASHINGTON, 2 SHKURT - Sekretari amerikan i Shtetit, Rex Tillerson, ndodhet për një turne në Amerikën Latine. Ai po jep gjatë vizitës mesazhin se Kina dhe Rusia janë duke marrë role "alarmante" në rajon dhe u bëri

thirrje autoriteteve të këtyre vendeve të zgjedhin si partnerë bashkëpunimi Shtetet e Bashkuara. Ai tha se Kina është duke u përpjekur ta shndërrojë rajonin e Amerikës Latine në një orbitë të saj. Por, ai tha se këtë

Kina po e bën përmes praktikave tregtare të padrejta me vende si Kili, Argjentina, Brazili dhe Peruja. Sekretari Tillerson tha se Kina është duke i dëmtuar sektorët e prodhimit në këto vende, duke shkaktuar

papunësi dhe duke ulur pagat e punëtorëve. Ndërsa e parë e Tillersonit ishte Meksika, më pas ai shkoi në Argjentinë, Peru, Kolumbi dhe ndërsa e tij e fundit është më 7 shkurt, në Xhamajka.



Trumpi autorizon publikimin e një raporti të klasifikuar



Dokumenti thuhet se përmban hollësi rreth përpjekjeve të Departamentit të Drejtësisë përpara zgjedhjeve presidenciale të 2016-s për t'i kërkuar leje gjykatës që të monitoroheshin kontaktet e mundshme të një këshilltari të fushatës së Trumpit me operativët rusë

WASHINGTON, 2 SHKURT - Presidenti i ShBA-së, Donald Trump, ka autorizuar publikimin e një raporti të klasifikuar, ku pretendohet se zyrtarët e lartë të zbatimit të ligjit janë treguar të njëanshëm ndaj presidentit. Media amerikane tha se ka gjasë që raporti të publikohet i plotë dhe pa redaktime. Si Byroja Federale e Hetimeve, ashtu edhe Departamenti i Drejtësisë, janë shprehur kundër publikimit të dokumentit. Të premtën, herët në mëngjes, presidenti Trump shkruante në "Twitter": "Udhëheqja e lartë dhe hetuesit e FBI-së si dhe Departamenti i Drejtësisë e kanë politizuar procesin e shenjtë hetimor në favor të demokratëve dhe kundër republikanëve gjë që, vetëm pak kohë më parë, do të kishte qenë e pamendueshme". Pak njerëz jashtë Kongresit e kanë lexuar dokumentin, i cili është hartuar

nga kongresisti republikan Devin Nunes. Dokumenti thuhet se përmban hollësi rreth përpjekjeve të Departamentit të Drejtësisë përpara zgjedhjeve presidenciale të 2016-s për t'i kërkuar leje gjykatës që të monitoroheshin kontaktet e mundshme të një këshilltari të fushatës së Trumpit me operativët rusë. Demokratët dhe kritikët e tjerë të dokumentit thonë se ai në mënyrë selektive përdor informacionin e klasifikuar të zbulimit për të arritur në përfundimin se hetimet mbi ndërhyrjen e Rusisë janë politikisht të njëanshme. Dy demokratët kryesorë në Kongres, udhëheqësi i pakicës në Senat, Charles Schumer dhe udhëheqësja e pakicës në Dhomën e Përfaqësuesve, Nancy Pelosi, e dënuan dokumentin dhe kritikuan udhëheqësit republikanë se po vendosnin interesin

partiak përpara sundimit të ligjit. Në vorbullën e kësaj zhurme partiake është përfshirë edhe FBI-ja, e cila ka publikuar një deklaratë të pazakontë, ku thuhet se ajo ka "shqetësime të mëdha" në lidhje me saktësinë e dokumentit. Dokumenti është shndërruar në një pikë konflikti në Uashingtonin e ndarë politikisht, ku një numër republikanësh po ankohen gjithnjë e më shumë për hetimet e prokurorit të posaçëm Robert Mueller rreth Rusisë. Ata ankohen se disa zyrtarë të Departamentit të Drejtësisë kanë punuar për ta minuar presidencën e Trumpit. Presidenti Trump ka thënë në mënyrë të përsëritur se nuk ekziston asnjë bashkëpunim i fshehtë mes fushatës së tij dhe Rusisë. Javën e kaluar ai tha se hetimit për Rusinë nuk i ishte nxjerrë asnjë pengesë.

LAJME SHKURT

Liderët gjermanë janë optimistë për arritjen e koalicionit

BERLIN, 2 SHKURT - Liderët e partive kryesore politike në Gjermani thonë se janë optimistë për finalizimin e marrëveshjes për formimin e "koalicionit të madh".



Përfaqësuesit e partisë Unioni Demokratik Kristian (CDU) i kancelares Angela Merkel, pastaj të partisë Unioni Social Krisitan (SCU) dhe Social Demokratët e krahut të majtë (SPD), planifikojnë të takohen ndaras, për t'u përgatitur për raundin final gjatë fundjavës. Partitë e kanë caktuar afatin deri më 4 shkurt për arritjen e marrëveshjes për koalicionin qeverisës derisa Angela Merkel mbetet kancelare. Andreas Scheuer nga SCU tha se është optimist, pavarësisht prej pengesave që ende duhet të kapërcehen.

Scott: Në Serbi gjithnjë e më tepër mite të pavërteta për ShBA-në

BEOGRAD, 2 SHKURT - Ambasadori i Shteteve të Bashkuara në Serbi, Kyle Scott, ka vlerësuar të premtën se mitet e pavërteta për Amerikën, të cilat, siç ka theksuar ai, i plasojnë



tabloidet e ndryshme në Serbi, janë bërë aq të shumta në numër, sa që populli serb "ka filluar të besojë në to". "Nëse i lexojmë tabloidet çdo ditë, do të mendoni se Amerika dëshiron vetëm gjëra të këqija për Serbinë, se Amerika është armik i Serbisë, se dëshiron kaos në Serbi dhe luftë në Ballkan. Të gjitha këto janë vetëm budallallëqe", ka deklaruar ambasadori Kyle Scott të premtën në qytetin e Nishit. Ai tha se politika e Shteteve të Bashkuara është e bazuar në atë që Serbia të jetë stabile dhe shtet i fortë, që jep kontribut në stabilitetin e gjithë rajonit, raporton agjencia "Beta" nga Beogradi. Ambasadori Scott të premtën në Universitetin e Nishit ka mbajtur ligjëratë në temën e komentimit të gabuar të politikës së Shteteve të Bashkuara në Serbi.

Zëdhënësi i Kremlinit kërkon falje për komentet për Putinin

MOSKË, 2 SHKURT - Zëdhënësi i Kremlinit, Dmitry Peskov, kërkoj falje pasi kreu i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në Rusi e qortoi atë për deklaratat publike që mund të interpretohen si fushatë zgjedhore për presi-

dentin Vladimir Putin. Peskov tha se i pranon parafjalërimet e Komisionit Qendror dhe se do të jetë i kujdesshëm me deklaratat. "Kërkoj falje për çdo deklaratë që mund të interpretohet si fushatë", tha Peskov.

Kryetarja e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Ella Pamfilova, nuk e specifikoi se për cilat deklaratat e ka fjalën, por besohet se ajo i është referuar vlerësimit të Peskovit se Putini "është përtej konkurrencës politike". "Nuk

mendoj se dikush mund të dyshojë se Putini është lider absolut i opinionit publik", ka thënë Peskov duke u përgjigjur në pyetjen nëse Kremlini i druhet politikanit opozitar, Aleksei Navalny.



Krenaria e Gjilanit, Makfire Osmani, i thotë disa fjalë për 10-vjetorin e pavarësisë

"Në prag të 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës udhëheqësia jonë duhet të vetëdijesohet më shumë. Prioritet në udhëheqje duhet t'u japë të rinjve që kanë aftësi profesionale dhe pjekuri politike e që kemi me bollëk", ka thënë veteranaria e arsimit, Makfire Osmani-Uzunaliç. Ajo ka folur edhe për kategorinë e pensionistëve. "Që 18 vjet kategoria jonë ballafaqohet me halle dhe probleme, pa status të pensionistit e pa dinjitet dhe trajtohemi si kategori sociale. Kështu nuk e kemi merituar", ka thënë Osmani-Uzunaliç.

GJILAN, 2 SHKURT (ER) - Duke u inspiruar nga thënia e Gabriel Garcia Marquezit, se "gazetari është dëshmitari i epokës në të cilën jeton", edhe ne deshëm që me shkrimin e znj. Makfire Osmani-Uzunaliç, e cila synon ta rivendosë drejtpeshimin shpirtëror dhe moral të shoqërisë, t'u lëmë kohëve dëshmi një copë shënim për të dhe brezin e saj. Ajo "nuk është politikane që jeton prej politikës, por politikane që jeton për politikën".

Veterania gjilanasë e arsimit, znj. Makfire Osmani-Uzunaliç, ambasadorja e Federatës Universale të Paqes nga radhët e pensionistëve, është e njohur si kontribuuese e madhe në arsimimin dhe edukimin e shumë brezave në Komunën e Gjilanit. E bija e Emin Ramush Osmanit, ish-kryetarit të Komunës së Gjilanit të viteve 1960-1963, Makfirja njihet si veprimtare patriotike përgjatë periudhave më të rënda të vendit tonë. Me rolet në shfaqjet e ndryshme teatrale dhe me aktivitete e ndryshme la gjurmë të thella në jetën kulturore të qytetit të Gjilanit. Ende mbahen në mend: je zëri dhe bukuria e saj kur, në vitet e '50-ta, si vajzë 16-vjeçare, këndoi këngën "Krisi pushka" në Teatrin e qytetit të Gjilanit.

Krenaria e Gjilanit, znj. Makfire Osmani, edhe sot në moshën e rreth 80-tave, me bukurinë, mençurinë dhe ideologjinë e saj për një shtet demokratik dhe të zhvilluar, vazhdon ta japë kontributin e çmuar për vendin tonë, për rininë dhe për më merituarit, pensionistët tanë. Ajo përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka shkruar për të arriturat e Kosovës si shtet në këtë dhjetëvjetor dhe për sfidat nëpër të cilat po kalon shteti ynë. "Jemi në prag të shënimit të 10-vjetorit të pavarësisë së shtetit, përvjetor i cili na bënë krenarë për të arriturat, por edhe na shqetëson për disa situata që po na ndodhin në dëm të shtetit dhe qytetarëve të Kosovës. Për tejkalimin e tyre nuk po shprehet angazhim i duhur

nga institucionet shtetërore dhe kategoritë e tjera shoqërore. Për fat të keq, ende shprehet bajraktarizmi, rrahja e gjoksit për patriotizëm, në vend se t'u jepet prioritet çështjeve mëdha të shtetndërtimit", ka shkruar ajo.

Veterania e arsimit ka shtuar se këto ditë disa kategorive të shoqërisë iu rriten pagat, por jo edhe pensionistëve. Për këtë çështje ajo ka dhënë edhe mendimin e vet. "Jemi një armatë e tërë e profileve dhe profesioneve të ndryshëm, që gjatë punës sonë, me shumë mund e djersë dhe në kushte shumë të vështira, dhamë kontributin tonë për përgatitjen e shtyllës së shtetit në zhvillimin ekonomik dhe politik të Kosovës, shtyllë për të cilën bijtë dhe bijat tona e flijuan jetën, rininë dhe i vunë themelet e shtetit, natyrisht, edhe me ndihmën e miqve të atdheut. Ia dolëm që ëndrra e gjeneratave tona të bëhet realitet për një shtet të lirë dhe të pavarur. Që 18 vjet kategoria jonë ballafaqohet me halle dhe probleme, pa status të pensionistit e pa dinjitet dhe trajtohemi si kategori sociale. Kështu nuk e kemi merituar!", ka thënë Osmani-Uzunaliç.

Ajo ka pohuar se, pavarësisht prej këtyre anashkalimeve, gjenerata e saj është krenare për punën që ka bërë për shtetndërtimin e Kosovës. "Pavarësisht prej këtyre anashkalimeve, jemi krenarë për punën tonë të shenjtë, duke edukuar dhe arsimuar gjenerata të tëra me radhë, duke ndërtuar fabrika dhe uzina për një jetë më të mirë të qytetarëve, punësim të rinjve (çfarë në kohën tonë janë realizuar!)", ka deklaruar veteranaria e arsimit, e cila për këtë dhjetëvjetor të shtetësisë ka edhe një porosi për udhëheqësin e shtetit. "Në prag të 10-vjetorit të pavarësisë së Republikës së Kosovës udhëheqësia jonë duhet të vetëdijesohet më shumë. Prioritet në udhëheqje duhet t'u japë të rinjve që kanë aftësi profesionale dhe pjekuri politike e që kemi me bollëk", ka thënë veteranaria e arsimit, Makfire Osmani-Uzunaliç.



Shoqatat myslimane të Senegalit e shpallin Rihannën "persona non grata"



Rihanna është shpallur "persona non grata" nga një grup organizatash fetare në Senegal, e cila po akuzohet se e ka ndërmend ta promovojë homoseksualizmin në bashkëpunim me masonët. Ylli amerikano-latin është

planifikuar të marrë pjesë në një konferencë rreth edukimit në vendin perëndimor afrikan, së bashku me presidentin francez Emmanuel Macron, në rolin e saj si ambasadore për Partneritetin Global për Arsimin.

Bebe Rexha: Vdekje, kush dëshiron të bëhet Valentimi im



Shën Valentini njihet si Dita e të Dashuruarve dhe festohet më 14 shkurt të vitit kalendarik. Por, edhe këtë vit Bebe Rexhën si duket do ta gjejë pa të dashur, megjithëse është një ndër këngëtares më të suksesshme shqiptare në rrafshin

ndërkombëtar. Bukuroshja ka lënë një mesazh ironik në rrjetin social "Instagram" "Vdekje. Kush dëshiron të jetë Valentimi im? E gjithë çka dëshiroj është një pako me çokollata dhe trëndafila të kuq", ka shkruar Bebe Rexha.



Dua Lipa ka nevojë për ndihmën e fansave në Brit Awards

Dua Lipa është një ndër këngëtares më të suksesshme shqiptare në rrafshin ndërkombëtar. Ajo së fundi ka publikuar këngën më të re të titulluar "Idgaf", e cila është shikuar mbi 52.2 milionë herë në

"YouTube". Dua Lipa është nominuar në pesë kategori të ndryshme të çmimeve vjetore të Brit Awardsit. Ajo ka kërkuar ndihmën e fansave, duke treguar se si mund të votoji në mënyrë që ajo ta rrëmbejë ndonjërin prej çmimeve.

Quincy Jones, 84-vjeçar, ka 22 të dashura anembanë botës



Quincy Jones mund të jetë 84-vjeçar, por mosha e vjetër nuk e ka ndaluar t'i joshë femrat. Në një intervistë për revistën "GQ", aktori ka zbuluar se ka partnere romantike anembanë botës, disa të reja 28-vjeçare. "Kam

22 të dashura", ka thënë Jones. Prodhuesi i famshëm i filmave ka gjashtë vajza dhe një djalë me ish-bashkëshortet Jeri Caldwell, Ulla Andersson dhe Peggy Lipton dhe ish të dashurat Carol Reynolds dhe Nastassja Kinski.

Rrugët e dyqaneve të luksit, ku bëjnë shopping më të pasurit e botës

Jo vetëm shopping në internet, por edhe në restorante, dyqane, kinema dhe palestër nuk heqin dorë

Cila është rruga më e shtrenjtë për shopping në botë? Avenue Fifth Avenue në Manhattan, veçanërisht midis Rrugës 49 dhe 60. Këtu janë dyqanet më luksoze në botë dhe për të marrë me qira këto dyqane të lakmuara, markat më prestigjioze paguajnë mesatarisht 28,262 euro për metër katror në vit. Ky është raporti i fundit mbarëbotërorë dedikuar rrugëve më të shtrenjta tregtare në planet, të shkruara nga Cushman & Wakefield (C & W), një kompani globale e pasurive të patundshme që ka monitoruar 451 vende në 68 vende dhe ka përpiluar një renditje gjithëpërfshirëse.

Në vendin e dytë në "top ten" janë dyqanet në zonën e Gjirit të Hong Kongut që tërheqin jo vetëm vëmendjen e Scrooge-it të ri të botës, por turma turistësh tërhiqen nga dritaret e shndritshme që e bëjnë zonën e mrekulueshme dhe shumë të lakmuar. Në këtë gj, markat e luksit shpenzojnë më shumë se 25 mijë euro për metër katror çdo vit për të shfaqur produktet e tyre, duke mohuar hipotezën se shopping në internet po rrezon punët e dyqaneve që shihen me rrugët e qyteteve

të mëdha.

Megjithatë, hapësira të mëdha dhe me gaz nuk janë të mjaftueshme për ta bërë një rrugë tërheqëse për të pasurit e botës, në fakt, në vendin e tretë në renditjen botërore, është rruga e vogël e New Bond, në Londër.

Një shtrirje e shkurtër e rrugës në jug të Bond Street, ku dyqanet luksoze janë të përqendruara. Këtu, dhënia me qira e një dyqani kushton mesatarisht 16,200 euro për metër katror në vit dhe Londra është gjithashtu më e populluara në mesin e më të pasurve në botë për të bërë blerje.

"Nëse pazaret online rriten me ritme të shpejta dhe shumë qendra tregtare mbyllin dyert e tyre, kërkesa për blerje luksoze, e personalizuar dhe e kombinuar me përvoja reale dhe të drejtpërdrejta, jo të riprodhuar online, rritet së bashku, - shpjegojnë analistët e C & W në raport. - Në veçanti, shpërblen biznesi i përqendruar në modë, ushqim, furnizim ushqimi, shitje me pije dhe aktivitetet të kohës së lirë, siç janë kinematë dhe qendrat e fitnessit. Përfundimisht e dyqaneve të sektorit të luksit vazhdojnë të japin një



"ndjenjë të vendit" ndaj markave duke përfurcuar të njëjtat shitje online".

Në vendin e katërt në renditjen botërore është një rrugë italiane: Via Monte Napoleone në Milano, me qira është rreth 13,500 euro për metër katror në vit.

Në vendin e pestë në renditje është rruga madhështore e Champs Elysees në Paris (këtu qiraja

tejkalon 13,000 euro për metër katror).

Në vendin e gjashtë, kaotiku Ginza, zona luksoze luksoze e Tokios (ku qiratë janë me vlerë 11.300 euro për metër katror).

Në pozitën e shtatë ekziston hapësira këmbësore dhe kozmopolitane e qendrës qendrore të biznesit Pitt Street Mall në Sidnei me qiratë në 9,500 euro për metër

katror.

I ndjekur më pas nga pazaret e çmendura dhe të shtrenjta në rrugët e Myeong-dong në Seul dhe Bahnhofstrasse në Cyrih, ndër rrugët më elegante në Evropë.

Në pozicionin e dhjetë, Kohlmarkt, vendoset përfundimisht rruga më ekskluzive në qendrën historike të Vienës.

(gazeta-Shqip.com)

Nuk iu kujtohet emri i Lady Diana? Fajin e ka ana e majtë e trurit!

Studimi i një grupi anglez botuar në "Cerebral Cortex". Sfida e hartës së 256 llojeve të kujtesës

Një herë një psikolog eksperimental u përpoq të numërojë të gjitha llojet ekzistuese të kujtesës, duke arritur një shifër të mrekulueshme 256. Edhe nëse ky numër nuk duhet të merret shumë seriozisht, mbetet fakti se kujtesa ka forma të shumëllojshme dhe ndoshta ka shumë mënyra për të harruar.

Duke mos qenë në gjendje të mbani mend emrin e një personi të famshëm është ndryshe nga harresa e asaj që quhet djalë qesharak i cili na fut në shtëpinë e një shoku, vetëm për të dhënë një shembull. Ajo përfshin të gjitha llojet e kujtesës, pra, është një ndërmarrje sfiduese për neuro-shkencën.

Elementin e fundit të enigmës e ka organizuar një grup anglez, duke botuar një studim mbi "Cortexin Cerebral". Titulli i shpalljes së Universitetit të Manchesterit nuk ka shkuar pa u vënë re: "A nuk ju kujtohet emri i Princeshës Diana? Faji qëndron në anën e majtë të trurit". Por çfarë saktësisht zbuluan studiuesit?

Testet psikologjike

Grace Rice dhe kolegët llogaritën me ndihmën e 41 pacientëve epileptikë, të cilët janë operuar për t'iu jetës normale. Kirurgët ndërhyjnë në një pjesë të indeve të përfshira në kujtesë, për të hequr epiqendrën e krizave. Në rreth gjysmën e pacientëve operacioni ka të bëjë me lobin e përcohshëm anterior të majtë, në gjysmën tjetër të djathtë.

Kur këta njerëz u janë nënshtruar një sërë testeve psikologjike për të vlerësuar efektet, u konfirmua se të dy hemisferat e trurit janë të rëndësishme për kujtesën. Por doli gjithashtu se ata që ishin operuar në të majtë e kishin më të vështirë se të tjerët të shprehnin verbalisht njohuritë e tyre për faktet e njohura.

Në mënyrë të veçantë, duke parë fotot e njerëzve të famshëm duke përfshirë edhe Princeshën Dianën, të përjetshmen Elizabeth II dhe një hol-



livudian të bukur si Brad Pitt, ndoshta ju kujtohet diçka nga identiteti i tyre, por jo emrat. Në praktikë, shprehja verbale e "kujtesës semantike" u dëmtua.

Amnezia

Rastësisht, kujtesa semantike apo konceptuale është ajo që lejon një konkurrenë të përgjig-

jet edhe kur prezantuesi i një quiz televiziv pyet: "Sa 'Oscar' për aktorin më të mirë fitoi Brad Pitt?". Por i njëjti emër dhe e njëjta fytyrë do të aktivizojë një tjetër lloj të kujtesës quajtur episodike, nëse kërkesa do të ishte drejtuar për Angelina Jolie që ka kujtime personale në lidhje me të. Lëxuesit e Umberto Eco kanë një dallim shumë të

qartë, sepse protagonist i "Flaka misterioze e mbretëreshës Loana" humbet kujtimet autobiografike duke i mbajtur të paprekur njohuritë ruajtur në kujtesën e tij enciklopedike.

Është ngushëlluese të mendojmë se mund të jetë faji i diferencës midis kujtesës episodike dhe semantike nëse një koleg herë pas here vjedh një nga idetë tona pa njohur meritën: kur e ka dëgjuar mund ta ketë ruajtur atë mirë dhe ka harruar rrethanat. Megjithatë, në jetën e përditshme, mekanizma të tjerë me siguri marrin përsipër kur njohim fytyrën e dikujt, por nuk e kujtojmë emrin.

Fytyra përmban një informacion shumë të rëndësishëm, sepse ajo përcjell emocionet, kështu që truri ynë është veçanërisht i aftë në identifikimin e tipareve të fytyrës. Ndërkohë emrat thonë pak, janë sekuenca vetëm arbitrare të simboleve, kështu që për t'i mbajtur mend duan më shumë përpjekje dhe është më e lehtë për t'i harruar. Përveç nëse personit në fjalë nuk i pëlqen aq shumë që të shkaktojë goditje rrufe. Në këtë rast, sigurohuni, mbani mend emrin tuaj dhe madje mbani numrin tuaj të telefonit. (gazeta-Shqip.com)

E jashtëzakonshme

Vendi ku jetohet mesatarisht 120 vjet

Në një krahinë malore në Pakistan njerëzit jetojnë mesatarisht deri në 120 vjet. Aty është një fis i tërë për të cilët të jetosh kaq shumë vite është bërë diçka normale. Banorët e Hunzas shprehin se ka disa arsye të cilat ndikojnë në jetëgjatësinë e tyre. Një 116-vjeçare ka treguar se sekretet e jetëgjatësisë së saj është fakti që ajo është beqare dhe nuk ka pranuar të dominohet nga askush.



FOTO E DITES



Një mace është parë duke kaluar gjatë një rrahjeje me dema në Kolumbi. /AFP/

E rrallë

Banorët frikësohen kur lumi ndryshon ngjyrën

Një lumë në qytetin e Tyumen në Rusi mund të paraqiste rrezik serioz për shëndetin e banorëve lokalë teksa u kthye në ngjyrë të kuqe të gjakut. Ekspertët janë të habitur nga fenomeni i çuditshëm, i cili ka bërë që njerëzit të kenë frikë nga cilësia e ujit të pijshëm. Agjencia shtetërore e lajmeve Itar-Tass e ka cilësuar incidentin një "bombë biblike".



